



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 14 (827766)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 8 Prill 2022

Gjeneralmajor Begaj: Sigurimi dhe menaxhimi i municioneve, proces dinamik

Ekspertë të menaxhimit të municioneve të shteteve partnere janë mbledhur në Tiranë, në forumin e dytë të Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Rezervës së Municioneve, të organizuar nën kujdesin e Departamentit të Shtetit të SHBA-së. Në sesionin e hapjes së forumit mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj dhe zëvendës ambasadori i SHBA-

ve në vendin tonë, z. Demian Smith. Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj vlerësoi këtë forum si një platformë e shkëlqyer për shkëmbimin e eksperiencave dhe mësimet të nxjerra nga vendet partnere në procesin e sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve, proces i cili duhet të konsiderohet si tepër i rëndësishëm. "Në këndvështrimin tim, procesi i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit

të Municioneve nuk është një proces statik, por ai është dinamik, i cili i nënshtrohet parimeve të transparencës, vijueshmërisë, llogaridhënies dhe ekspertizës të vazhdueshme. Situata e sigurisë në rajon dhe më gjerë po përballët me sfida të mëdha, ndaj ky proces duhet të konsiderohet si një përpjekje e përbashkët që kërkon modernizim dhe trajnim të rregullt të ekspertëve"...

» faqe 2



Shqipëria 13 vjet në NATO

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Do të shtojmë kontributet pro paqes dhe lirisë në botë



» faqe 3

Kundëradmiral Adnand Agastra priti kundëradmiralin Don Mackinnon të Forcës Detare të Mbretërisë së Bashkuar

Kundëradmiral Don Mackinnon, komandanti i Forcave të Kollonit të Operacionit "SENTINEL", gjatë zhvillimit të një vizite zyrtare në vendin tonë, u prit në mjediset e Komandës së Forcës Detare nga kundëradmiral Adnand Agastra. Qëllimi i vizitës ishte vijimi i procedurave ligjore për angazhimin e FARSH dhe dislokimi i personelit të Forcës Detare në këtë operacion. Gjithashtu u diskutua mbi operacionet për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme për bllokimin e lundrimit të lirë në zonën e operacionit...



» faqe 2

Nënkolonel Dulemata: Dëshmorët e Aviacionit janë simboli i sakrificës dhe vetëmohimit në emër të detyrës, nderit dhe atdheut

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ceremonia përkujtimore e pilotëve-Dëshmorë të Atdheut kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, të rënë në krye të detyrës. Të pranishëm në ceremoni ishin, komandanti i Bazës Ajrore Farkë, nënkolonel Julian Dulemata, familjarë të Dëshmorëve të Atdheut, përfaqësues të shoqatës së familjeve të Dëshmorëve e Aviatorëve të Shqipërisë, si dhe pilotë e efektivë të Forcës Ajrore. Komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata në fjalën e tij...



» faqe 5

"Nëse nuk kemi paqe, është sepse kemi harruar që i përkasim njëri-tjetrit"

Paqa në sensin psikologjik pasqyron një gjendje të shëndetshme, të qetësisë dhe harmonisë. Në veçanti, paqa nënkupton mungesën e luftës apo të dhunës. Të jetuarit së bashku në paqe ka të bëjë me pranimin e dallimeve dhe me aftësinë për të dëgjuar, njohur, respektuar dhe vlerësuar të tjerët si dhe të jetosh në një mënyrë paqësore dhe të bashkuar. Rëndësia e të jetuarit së bashku në paqe është përditshmëri, por, më 16 maj, kjo vlerë e njerëzimit vlerësohet edhe më lart, kur shënohet "Dita Ndërkombëtare e të Jetuarit së Bashku në Paqe", datë kjo e shpallur nga Kombet e Bashkuara...



» faqe 6

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti në një takim të veçantë ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Kroacisë Mario Banožić. Vizita zhvillohet në një moment të shënuar për të dy vendet, të cilat festuan 13-vjetorin e anëtarësimit në NATO. Dy ministrat zhvilluan fillimisht një bisedë “tête-à-tête” dhe më pas një takim mes dy delegacioneve. Në qendër të diskutimeve ishin raportet shumë të mira mes dy vendeve, kontributi i tyre në kuadër të Aleancës si dhe situata e krijuar në të gjithë botën nga agresioni rus në Ukrainë.

Në konferencën e përbashkët për mediat, ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, z. Niko Peleshi tha se: “Pushtimi ushtarak i Ukrainës është një agresion i qartë, një luftë e paligjshme dhe kriminale kundër një vendi sovran. Shqipëria e ka dënuar menjëherë këtë akt të paprovokuar agresioni, duke dhënë kontribut të dorës së parë në fushën e diplomacisë (nga OSBE, NATO në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si anëtare e përkohshme), por edhe ndihmë konkrete ushtarake”.

Të dy vendet, si Shqipëria ashtu edhe Kroacia kanë mbajtur të njëjtin qëndrim në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon e më gjerë.

Ministri Peleshi theksoi se: “Situata në Ukrainë na dha një mësim të madh. Hezitimi për të zbatuar me vendosmëri politikën e dyerve të hapura, hezitimi për të pranuar vendet që duan të përqafojnë vlerat perëndimore, në NATO dhe BE është një gabim i madh. Ne duhet të ngremë zërin që të tjerët të kuptojnë rëndësinë e integritetit euroatlantik për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor”.

Në këtë pikë, ministri Peleshi nënvizoi rëndësinë që ka mbështetja e Kosovës në aspiratat e saj kundrejt anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e paqes dhe sigurisë. Ministri Peleshi



MINISTRI I MBROJTJES SË KROACISË, VIZITË NË SHQIPËRI

Ministri Peleshi: Të ngremë zërin për rëndësinë e integritetit euroatlantik për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor



vuri në dukje faktin që anëtarët e Forcave të Armatosura të dy vendeve operojnë përsëri krah njëri-tjetrit në Kosovë.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes i Kroacisë, Mario Banožić falënderoi për mikpritjen ministrin Peleshi si dhe

shprehu mbështetjen e pakursyer të vendit të tij në rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ministri Banožić theksoi rëndësinë e Aleancës së NATO-s, veçanërisht në sfidat e sigurisë me të cilat përballlet sot Europa, por edhe globi. “Situata aktuale



tregon edhe një herë se anëtarësimi euroatlantik është jetik për vendet e rajonit tonë. Shpreh mbështetjen time të fortë për Republikën e Shqipërisë në anëtarësimin sa më të shpejtë të saj në Bashkimin Europian”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes së Kroacisë.

Të dy ministrat shprehën gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në nivel dypalësh, kryesisht përmes edukimit dhe trajnimit, si dhe angazhimit të mëtejshëm të Forcave të Armatosura në operacionet e udhëhequra nga NATO.

Forca Detare

Kundëradmiral Don Mackinnon, komandanti i Forcave të Koalicionit të Operacionit “SENTINEL”, gjatë zhvillimit të një vizite zyrtare në vendin tonë, u prit në mjediset e Komandës së Forcës Detare nga kundëradmiral Adnand Agastra.

Qëllimi i vizitës ishte vijimi i procedurave ligjore për angazhimin e FARSH dhe dislokimi i personelit të Forcës Detare në këtë operacion. Gjithashtu u diskutua mbi operacionet për parandalimin e aktivitetëve të paligjshme për bllokimin e lundrimit të lirë në zonën e operacionit, angazhimi i FARSH dhe dislokimi i personelit të Forcës Detare në operacionin “SANTINEL”.



Kundëradmiral Adnand Agastra priti kundëradmiralin Don Mackinnon të Forcës Detare të Mbretërisë së Bashkuar



Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios eliminojnë rrezikun e municioneve të gjetura në Bashkinë Kamëz

Specialistët xhenierë të EOD, të Batalionit të Xhenios pas sinjalizimit për gjetje municionesh të paplasura në Bashkinë Kamëz, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe pas kryerjes së vlerësimit të rastit, ndoqën procedurat për mënjanimin e rrezikut të municioneve të evidentuara.

Pas vlerësimit, u konstatua nga ana e ekipit, si municion i paprekshëm dhe i palëvizshëm, që kërkon asgjësim në vend. Grupi xhenier hasi vështirësi për shkak se predha ndodhej pranë një shtylle të tensionit të lartë, megjithatë operacioni u krye me sukses. Komanda Mbështetëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në vite, duke shpalosur një kapacitet të vyer jo vetëm në shërbim të misionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e asgjësimit të municioneve të paplasura në poligonet ushtarake, por edhe në shërbim të komunitetit për eliminimin e rrezeve të municioneve të gjetura si në zonat rurale ashtu dhe ato urbane.



13 vite në NATO!

Yuri Kim: “Më 1 Prill 2009, forcat amerikane dhe ato shqiptare kanë derdhur gjak, djersë dhe lot së bashku në fushëbeteja”. Ambasadorja shton se ekspertët amerikanë shumë shpejt do të fillojnë një program të ri në Shqipëri për përmbushjen e objektivave të aftësisë së NATO-s. “Më 1 Prill 2009, Shqipëria u bë zyrtarisht anëtare e NATO-s. Që atëherë, forcat u bashkuan në Afganistan, Irak, BiH, Kosovë. Roli dhe vlera si një aleat i NATO-s po rritet vazhdimisht. Vitin e kaluar, Shqipëria priti stërvitjen më të madhe ushtarake të udhëhequr ndonjëherë në Ballkanin Perëndimor. Këtë vit, NATO filloi të përmirësojë bazën ajrore në Kuçovë për t’u bërë një objekt i NATO-s. Së shpejti, ekspertët amerikanë do të fillojnë një program të ri për të siguruar përmbushjen e objektivave të aftësisë së NATO-s. SHBA është krenare që është aleate me Shqipërinë.”

Yuri Kim uron shqiptarët: Krenarë që jemi aleatë me Shqipërinë!



Shqipëria 13 vjet në NATO

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Do të shtojmë kontributet pro paqes dhe lirisë në botë

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi ka uruar shqiptarët dhe veçanërisht Forcat e Armatosura për këtë ditë të shënuar:

“Pavarësisht periudhave të caktuara, vokacioni i popullit shqiptar ka qenë ndër shekuj perëndimor. 13 vjet më parë ky vokacion u materializua me anëtarësimin e Shqipërisë në aleancën më të madhe politiko-ushtarake që ka njohur bota. Që prej asaj dite, por edhe më herët, trupat shqiptare kanë shërbyer pothuajse në çdo mision të NATO-s. Kontributi ynë, si një aleat i denjë i Aleancës, do të shtohet çdo ditë e më tepër me qëndrimet dhe veprimet tona pro paqes dhe lirisë në botë.

Gëzuar 13-vjetorin e Shqipërisë në NATO!”, -thekson në mesazhin e tij, ministri Peleshi.

Në këtë 13-vjetor, Forcat e Armatosura janë në një proces reformimi dhe modernizimi.

Më 1 prill 2009, Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut - NATO, pas përfundimit të ratifikimit të Protokollit të Anëtarësimit nga të gjitha vendet aleate dhe depozitimit të instrumentit të aderimit në NATO, në Departamentin e Shtetit, që është edhe mbajtësi ligjor i Traktatit të Uashingtonit.

NATO-ja - POLITIKE promovon vlerat demokratike dhe u mundëson anëtarëve të konsultohen dhe të bashkëpunojnë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë që të zgjidhin problemet, të krijojnë besim dhe për një afat të gjatë të parandalojnë konfliktin.

NATO-ja - USHTARAKE është e angazhuar për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Nëse përpjekjet diplomatike dështojnë, ajo ka fuqinë ushtarake për të ndërmarrë operacione për administrimin e krizave. Këto realizohen sipas klauzulës së mbrojtjes kolektive të traktatit themelor të NATO-s - Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit ose - sipas mandatit të Kombeve të Bashkuara, vetëm ose në bashkëpunim me vende të tjera dhe organizata ndërkombëtare.

Çdo ditë, vendet anëtare konsultohen dhe marrin vendime për çështjet e



sigurisë në të gjitha nivelet dhe në fusha të ndryshme.

Një “vendim i NATO-s” është shprehja e vullnetit kolektiv të 30 vendeve anëtare, meqenëse të gjitha vendimet merren me konsensus.

Qindra nëpunës, ashtu si dhe ekspertë civilë e ushtarakë, shkojnë çdo ditë në Selinë Qendrore të NATO-s për të shkëmbyer informacione, për të shkëmbyer ide dhe për të ndihmuar në përgatitjen e vendimeve kur është e nevojshme, në bashkëpunim me delegacionet kombëtare dhe personelin në Selinë Qendrore të NATO-s.

NATO-ja gjithmonë ka përtërirë dhe adaptuar veten për të siguruar që politikën, aftësitë dhe strukturën e saj të marrin masa për kërcënimet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë mbrojtjen

kolektive të anëtarëve të saj.

40 vende jo anëtare punojnë me NATO-n në një gamë të gjerë çështjesh politike dhe të sigurisë. Këto vende çojnë përpara dialogun dhe bashkëpunimin praktik me Aleancën dhe shumë prej tyre kontribuojnë në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO-ja.

NATO-ja po bashkëpunon gjithashtu me një rrjet të gjerë organizatash ndërkombëtare. Vendet partnere nuk kanë të njëjtin autoritet vendimmarrës si vendet anëtare.

Çdo ditë, vendet anëtare konsultohen dhe marrin vendime për çështjet e sigurisë në të gjitha nivelet dhe në fusha të ndryshme. Një “vendim i NATO-s” është shprehja e vullnetit kolektiv të 30 vendeve anëtare meqenëse të gjitha vendimet merren me konsensus.



Ekspertë të menaxhimit të municioneve të shteteve partnere janë mbledhur në Tiranë, në forumin e dytë të Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Rezervës së Municioneve, të organizuar nën kujdesin e Departamentit të Shtetit të SHBA-së.

Në sesionin e hapjes së forumit mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj dhe zëvendës ambasadori i SHBA-ve në vendin tonë, z. Demian Smith. Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj vlerësoi këtë forum si një platformë e shkëlqyer për shkëmbimin e eksperiencave dhe mësimëve të nxjerra nga vendet partnere në procesin e sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve, proces i cili duhet të konsiderohet si tepër i rëndësishëm.

“Në këndvështrimin tim, procesi i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Municioneve nuk është një proces statik, por ai është dinamik, i cili i nënshtrohet parimeve të transparencës, vijueshmërisë, llogaridhënies dhe ekspertizës të vazhdueshme. Situata e sigurisë në rajon dhe më gjerë po përballet me sfida të mëdha, ndaj ky proces duhet të konsiderohet si një përpjekje e përbashkët që kërkon modernizim dhe trajnim të rregullt të ekspertëve”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj falënderoi ambasadën e SHBA-së në Tiranë, Komandën e SHBA-së për Europën (US EUCOM), si dhe Kompaninë “Golden West”, për rolin aktiv në projektet e modernizimit të depove të municionit dhe trajnimin e personelit,



Gjeneralmajor Begaj: Sigurimi dhe menaxhimi i municioneve, proces dinamik

duke marrë si shembull depon e municionit të Mirakës së rikonstruktuar me mbështetjen e palës amerikane.

Forumi i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Rezervës së Municioneve, i cili zhvillohet për herë të parë në Tiranë, ka bashkuar personel ushtarak ekspert nga Shqipëria, Gjeorgjia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Qipro, të asistuar nga ekspertë të Holandës dhe Komandës së SHBA-së për Europën. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi që të shkëmbejnë eksperiencat e vendeve të tyre në fushën e menaxhimit të municioneve, si dhe do të vizitojnë disa nga projektet e modernizimit të FARSH, të mbështetura nga pala amerikane.



BASHKËPUNIMI

Gjeneralmajor Begaj priti atasheun ushtarak të sapo akredituar të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Boycott

Në kuadër të marrjes së detyrës si atashe ushtarak në Tiranë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar për Shqipërinë dhe Malin e Zi, nënkolonel Timothy Wight-Boycott.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, në fjalën e tij, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, veçanërisht në fushat e trajnimit, arsimimit dhe stërvitjeve, duke nënvizuar rolin aktiv të Zyrës së Atasheut Ushtarak të Britanisë në Tiranë.

Nga ana e tij, nënkolonel Boycott e siguroi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH se është i hapur për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve bilaterale, duke punuar me të njëjtin intensitet si paraardhësi i tij në detyrë.

Në përfundim të takimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjen-



eralmajor Begaj, duke i uruar suksese në detyrë, e garantoi nënkolonel Boycott mbi mbështetjen e FARSH në

thellimin e bashkëpunimit dhe eksplorimit të mundësive të reja me interes të përbashkët.



Takimi

Gjeneralmajor Begaj: Roli i IMSC-së, i rëndësishëm për sigurinë detare në Lindjen e Mesme, Europë dhe më gjerë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim kortezie, komandantin e Njësisë Ndërkombëtare të Sigurisë Detare (IMSC - International Maritime Security Construct) dhe njëkohësisht komandant i Forcës Detare Ndërkombëtare “Sentinel” në Bahrein, kundëradmiralin Don Mackinnon.

Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin e kësaj strukture, jo vetëm për sigurinë detare në Lindjen e Mesme, por edhe për sigurinë e Europës dhe më gjerë, veçanërisht kjo nën efektet e shkaktuara në ambientin e sigurisë nga ndërhyrja e Rusisë në Ukrainë. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj e njohu kundëradmiralin Mackinnon me aktivitetet ndër vite të Forcës Detare të RSH në kuadër të NATO-s dhe nismave rajonale, si dhe e garantoi komandantin e “Sentinel” mbi gatishmërinë e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për përshejtimin e procesit të kontributit me personel të Shqipërisë në strukturën e IMSC. Nga ana e tij, komandanti i “Sentinel” vlerësoi rolin e Shqipërisë në sigurinë detare dhe kontributet në Aleancën e NATO-s, duke përcjellë angazhimin e tij personal për nxitjen e procesit të nënshkrimit të marrëveshjes respektive me vendin pritës (Bahrein) për konkretizimin e kontributit me personel nga Shqipëria pranë kësaj strukture.

Vizita e komandantit të “Sentinel” në Shqipëri përfshin një takim pune në Komandën e Forcës Detare, ku do të njihet më nga afër me kapacitetet dhe aktivitetet e Forcës Detare.



Ceremoni përkujtimore në Bazën Ajrore Farkë - Dëshmorë të Atdheut, kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha

Nënkolonel Dulemata: Dëshmorët e Aviacionit janë simboli i sakrificës dhe vetëmohimit në emër të detyrës, nderit dhe atdheut

Frymëzim për brezat e pilotëve

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ceremonia përkujtimore e pilotëve-Dëshmorë të Atdheut kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, të rënë në krye të detyrës. Të pranishëm në ceremoni ishin, komandanti i Bazës Ajrore Farkë, nënkolonel Julian Dulemata, familjarë të Dëshmorëve të Atdheut, përfaqësues të shoqatës së familjeve të Dëshmorëve e Aviatorëve të Shqipërisë, si dhe pilotë e efektivë të Forcës Ajrore.

Komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata në fjalën e tij theksoi: “Nderojmë me përvulje dhe respekt kapitenin Floran Delia dhe togerin Donald Hoxha, të cilët si sot gjashtë vite më parë humbën jetën e tyre në krye të detyrës. Florani dhe Donaldi, pilotët dhe vëllezërit tanë në uniformë shënuan emrat e tyre në piedestalin e vlerave dhe sakrificave të këtij profesioni fisnik duke u bërë nderi dhe krenaria jonë. Dëshmorët e Aviacionit janë jo vetëm simboli i sakrificës dhe vetëmohimit në emër të detyrës, nderit dhe atdheut por janë frymëzim për brezat e pilotëve”. Në fund të fjalës së tij, komandanti i Bazës Ajrore Farkë ftoi të pranishmit të mbanin një minutë heshtje në nderim të Dëshmorëve të Atdheut. Në emër të familjarëve përshëndeti babai i Dëshmorit të Atdheut Donald Hoxha, i cili falënderoi Forcat e Armatosura dhe Komandën e Forcës Ajrore, Bazën Ajrore Farkë për nderimin dhe respektin e treguar ndaj bijve të tyre. Ceremonia u mbyll me vendosjen e kurorave dhe buqetave me lule tek Memoriali i Dëshmorëve në Bazën Ajrore Farkë dhe Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.



NËNKOLONEL DULEMATA

“Nderojmë me përvulje dhe respekt kapitenin Floran Delia dhe togerin Donald Hoxha, të cilët si sot gjashtë vite më parë humbën jetën e tyre në krye të detyrës. Florani dhe Donaldi, pilotët dhe vëllezërit tanë në uniformë shënuan emrat e tyre në piedestalin e vlerave dhe sakrificave të këtij profesioni fisnik duke u bërë nderi dhe krenaria jonë”.



Përkujtimore

“Dëshmorët e Atdheut”, kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha ranë në krye të detyrës gjashtë vite më parë, si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC -145 në Malësinë e Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor.

Prilli i para 6 viteve u ndal në gjysmë, pranverën e re nuk do e shijonin më dy djemtë e rinj, “shqiponjat e qiellit”, Florani dhe Donaldi. Sot dhe përgjithmonë ne do kujtojmë dëshmorët tanë, inspirimin e brezave në vite.

Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublimë dhe vetëdija e ngritur lart, deri në piedestalin e vetëfljimit. Breza të tërë pas nesh do i kujtojnë ata!

Dëshmorëve u këndohen këngë trimërie, si këto fjalë zemre që në vijë melodike vijnë për dëshmorët tanë:

*Nga Trupi po prapë
Shfaqet një ylber,
Flamuri kuq e zi valëvitet në erë
Është komandant Hoxha
Mbi helikopter,
Legjendë e vendit
Do mbetesh përherë.
Aty në ballkon ka mbetur nëna
Me buzët që dridhen për djalin e saja,
Me mision u nise për të fundit herë
Bashkë me Floranin ju mbetët në qiell.
Ata që të njohin të kujtojnë me mall
Dëshmorët e atdheut, përjetë jeni gjallë,
Një shembull i ndritur
Për brezat që vijnë,
Atdheut që deshët ia rritët lavdinë.*

Kujtimet e vetme që kemi për dëshmorët janë përmendoret, lapidarët, dhe kujtesa historike që na bën të jemi krenarë.

**I përjetshëm
kujtimi i bijve tanë!**



Dëshmorët e atdheut, dëshmia historike e frymëzimit në breza

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Paqja në sensin psikologjik pasqyron një gjendje të shëndetshme, të qetësisë dhe harmonisë. Në veçanti, paqja nënkupton mungesën e luftës apo të dhunës.

Të jetuarit së bashku në paqe ka të bëjë me pranimin e dallimeve dhe me aftësinë për të dëgjuar, njohur, respektuar dhe vlerësuar të tjerët si dhe të jetosh në një mënyrë paqësore dhe të bashkuar. Rëndësia e të jetuarit së bashku në paqe është përditshmëri, por, më 16 maj, kjo vlerë e njerëzimit vlerësohet edhe më lart, kur shënohet “Dita Ndërkombëtare e të Jetuarit së Bashku në Paqe”, datë kjo e shpallur nga Kombet e Bashkuara.

Disa nga misionarët më të theksuar të paqes, padyshim që janë pjesëtarët KFOR-it, ata që çdo ditë punojnë në krijimin e një ambienti sa më paqësor.

Për ushtarin e kontingjentit Danez, Inan, shpërndarja e paqes është mision i tij, jo vetëm që ia ka deleguar detyra, por edhe nga jeta: “Prindërit e mi janë nga Turqia, mirëpo unë kam lindur dhe jam rritur në Danimarkë, kështu që unë di ca për bashkëjetesën, kam përvojë diskriminimi vetë në jetën time andaj sot po i ndihmoj të tjerët që të jetojnë së bashku në paqe pa diskriminim, diçka që unë e vlerësoj shumë”.

Se të jetuarit bashkë, duke respektuar dhe kuptuar njëri-tjetrin tejkalon çdo sfidë dhe prodhon ambient paqësor.

Është shumë e rëndësishme që të jetojmë në paqe dhe të trajtojmë njëri-tjetrin ashtu si ne do të donim që të tjerët të na trajtonin neve. Feja, ngjyra e lëkurës dhe kombësia nuk janë të rëndësishme. Është e rëndësishme të jesh njerëzor dhe ta mbash gjithmonë këtë në mendje.

Që të jetojmë së bashku në paqe, vetëm duhet t'i pranojmë dallimet mes njerëzve. Diversiteti e bën botën të bukur, dhe duhet të kemi aftësinë për të dëgjuar, njohur, respektuar dhe vlerësuar të tjerët, pa dallim kulture apo etnie.

Shkrimtari Elie Wiesel në një nga veprat e tij shkruan: “Paqja është dhurata jonë për njëri-tjetrin”, ndaj ta dhurojmë atë çdo ditë, në shoqërinë tonë, në rrethin tonë dhe gjithandej ku jeta gëlon.

Thonë se që të ketë paqe në botë, si fillim, paqja duhet të fillojë tek individ. Kjo mund të jetë shumë e vërtetë, por me fjalë. Fjalë të cilat duken optimiste, fjalë që kur i dëgjon të bëjnë të buzëqeshësh, por njëkohësisht edhe fjalë që të bëjnë të rebelohesh. Të rebelohesh e detyruar nga indiferentizmi dhe mungesa e theksuar e solidaritetit. Mijëra fëmijë vdesin përditë në Siri, Afganistan, Ukrainë. Padrejtësi.

Realiteti, politika dhe filozofia e interesit po na çojnë sot në një verbim të gjithanshëm. Unë me të vërtetë nuk e di më se çfarë është paqja kur çdo ditë e imja ka disa

Të jetuarit së bashku në paqe ka të bëjë me pranimin e dallimeve dhe me aftësinë për të dëgjuar, njohur, respektuar dhe vlerësuar të tjerët si dhe të jetosh në një mënyrë paqësore dhe të bashkuar. Rëndësia e të jetuarit së bashku në paqe është përditshmëri, por, më 16 Maj, kjo vlerë e njerëzimit vlerësohet edhe më lart, kur shënohet “Dita Ndërkombëtare e të Jetuarit së Bashku në Paqe”, datë kjo e shpallur nga Kombet e Bashkuara.

“Nëse nuk kemi paqe, është sepse kemi harruar që i përkasim njëri-tjetrit”



NDRYSHIMI

Lufta ekziston ende sot. Ne nuk kemi mësuar ende të menaxhojmë dimensionin kozmopolit në të cilin jemi zhytur. Ndryshimet kanë qenë të shpejta dhe të mëdha. Por ne nuk kemi ndryshuar. Zigmunt Bauman: “S’kemi ndryshuar as mënyrën se si veprojmë dhe lidhemi me të tjerët. Pra nuk jemi bërë ende një “ne” e tërë”.



momente “kronikë e zezë”. Rugës shoh njerëz të ulur në trotuar, të shfrytëzuar deri në frymën e fundit, duke lypur. Zëra të mjerë e vrastarë më plagosin shpirtin. “Na fal noi lek”, pleq që përplasen rrugëve e urbanëve të mbushur me zymtësinë, vrazhdësinë e indiferentizmin e njerëzve. Ky është refreni i ditës sime aq sa edhe Migjeni do ta kishte zili.

Qytetarët e mi kanë harruar të qeshin, ata vetëm kërkohen, prindërit e mi s’duan të protestojnë se ndihen të pambrojtur, fqinjët e mi s’duan të qetë të jetojnë.

Ku po shkojmë? Deri kur?

Ne kemi harruar të dashurojmë, kemi harruar se shpirti është krijuar për të dashur e për të falur.

Kjo nuk është mënyra se si unë kërkoj të rritem dhe të ris fëmijën tim, të edukohem, dhe të edukoj të ardhmen e këtij vendi, të krijoj parimet e mia, të zbatoj parimet e shoqërisë dhe të familjes. Por jam e frikësuar, të marr virtytet e jetës së përditshme, sepse ato të kthejnë në një njeri jo paqësor, në një qenie të frikshme dhe që i cenon gjithkujt paqen dhe sigurinë. Askush nuk do

të jetojë pa qenë i sigurt, pasi siguria është gjithçka për jetën e individit.

Ndoshta dhe s’mund të jeni dakord me mua. Unë nuk jam revolucionare, madje as nuk e njoh doktrinën filozofike të komunizmit, por këtë botë nuk e dua kështu. Shenjtorja e madhe, hyjnorja Nënë Tereza u shenjtërua në emër të paqes dhe dashurisë njerëzore. Mos duhet të presim ndonjë mrekulli tjetër? Shenjtorja shqiptare na flet nga lart: “Nëse nuk kemi paqe, është sepse kemi harruar që i përkasim njëri-tjetrit”, ty, atij, atyre, të gjithëve, në lagjen time, në komunitetin tim, në qytetin tim, vendin tim, fqinjin afër dhe larg meje.

Unë mendoj se ëndrrat mund të bëhen realitet. Dhe ëndrra e paqes dhe sigurisë është më e bukura që unë shoh në gjumë, me sy e mendje hapur. Le ta nisim së bashku rrugën drejt dashurisë, rrugën drejt paqes dhe sigurisë. E fqinjët, miqtë e dashamirët me emër le të na ndihmojnë.

“Kur do të përfundojë e gjitha kjo?”, -është pyetja ndoshta më e shpeshtë e bërë javët e fundit. Ajo e Ukrainës, është vetëm një nga luftërat që po ndodhin aktualisht në botë. Sot

po luftohet edhe në Etiopi, Jemen, Sahel, Nigeri, Afganistan, Liban, Sudan, Haiti, Kolumbi dhe Mianmar.

Ka shumë popuj që janë të detyruar të largohen nga vendi i tyre, dhe po të shumtë janë edhe ata që luftojnë, me të gjitha armët që kanë në dispozicion, për hir të dashurisë ndaj atdheut dhe familjeve të tyre.

Po kur do të përfundojë e gjithë kjo? Kur do të mund të jetojmë më në fund në një botë ku të mos ekzistojnë më lufta dhe armët?

Zhvillimi i ngjarjeve të tilla dukej i pamundur në vitin 2022, e megjithatë po ndodh. Ndërkaq, ka edhe nga ata që i frikësohen nisjes së një Luftë të Tretë Botërore.

Por pse historia e largët po bëhet pjesë e së tashmes sonë?

Ne, si produkt i së kaluarës sonë, nuk duhet të jemi rob të saj. Mjafton të studiojmë të kaluarën dhe patjetër do mund të përcaktonim të ardhmen.

Si ka mundësi, që pavarësisht progresit dhe historisë, që duhet të na mësojë të mos i përsërisim gabimet e së shkuarës, jemi sërish në këtë pikë?

Sociologu dhe filozofi Zigmunt

Bauman ka folur shumë herë mbi natyrën e paqes dhe konfliktit. Fjalët e tij mbi këtë çështje, mund të hedhin më shumë dritë mbi dyshimet tona, dhe t’u japin përgjigje pyetjeve që shpesh nuk kemi kujt t’ia drejtojmë.

Lufta është e kaluara apo e tashmja jonë?

Lufta ekziston ende sot. Ne nuk kemi mësuar ende të menaxhojmë dimensionin kozmopolit në të cilin jemi zhytur. Ndryshimet kanë qenë të shpejta dhe të mëdha. Por ne nuk kemi ndryshuar. Zigmunt Bauman: “S’kemi ndryshuar as mënyrën se si veprojmë dhe lidhemi me të tjerët. Pra nuk jemi bërë ende një “ne” e tërë”.

Pyetja është, a do të jemi ndonjëherë?

Mosbesimi ynë në të ardhmen e bën të vështirë heqjen dorë nga e kaluara.

“E kaluara nuk ka vdekur, është e gjallë me ne dhe do të jetë e gjallë në të ardhmen që ne po ndihmojmë të bëjmë”.

Nëse na duhet të ndërtojmë botën me llaç dhe tulla, që më pas t’i shkatërrojmë le të ndërtojmë paqen që jeta të vazhdojë....

“Në këmbë, ndërtues të paqes!”

NJË HISTORI E
SHKURTËR E DRONËVE

Mjetet ajrore pa pilot (UAV) janë avionë pa ekuipazh ose pasagjerë në bord. Ato mund të jenë “dronë” të automatizuar ose mjete të pilotuara në distancë (RPV). UAV-të mund të fluturojnë për periudha të gjata kohore në një nivel të kontrolluar shpejtësie dhe lartësie dhe kanë një rol në shumë aspekte të aviacionit.

Mjetet e para pa pilot u zhvilluan në Britani dhe SHBA gjatë Luftës së Parë Botërore. “Aerial Target” i Britanisë, një avion i vogël i kontrolluar me radio, u testua për herë të parë në mars 1917 ndërsa siluri ajror amerikan i njohur si “Kettering Bug” fluturoi për herë të parë në tetor 1918. Edhe pse të dy treguan premtues në testet e fluturimit, asnjëra nuk u përdor në mënyrë operative gjatë luftës.

Gjatë periudhës ndërmjet luftës, zhvillimi dhe testimi i avionëve pa pilot vazhdoi. Në 1935 britanikët prodhuan një numër avionësh të kontrolluar me radio që do të përdreshin si objektiva për qëllime stërvitore. Mendohet se termi “dron” filloi të përdoret në këtë kohë, i frymëzuar nga emri i një prej këtyre modeleve, DH.82B “Queen Bee”.

UAV-të e zbulimit u vendosën për herë të parë në një shkallë të gjerë në Luftën e Vietnamit. Dronët gjithashtu filluan të përdoren në një sërë rolesh të reja, të tilla si të veprojnë si mashtrime në luftime, të lëshojnë raketa kundër objektivave fikse dhe të hedhin fletëpalosje për operacione psikologjike.

Pas Luftës së Vietnamit, vende të tjera jashtë Britanisë dhe Shteteve të Bashkuara filluan të eksplorojnë teknologjinë ajrore pa pilot. Modelet e reja u bënë më të sofistikuar, me qëndrueshmëri të përmirësuar dhe aftësi për të mbajtur lartësi më të madhe. Vitet e fundit janë zhvilluar modele që përdorin teknologji të tilla si energjia diellore për të trajtuar problemin e nxitjes së fluturimeve më të gjata.

Dronët tani kanë shumë funksione, duke filluar nga monitorimi i ndryshimeve klimatike deri të kryerja e operacioneve të kërkimit pas fatkeqësive natyrore, fotografimi, filmimi dhe dërgimi i mallrave. Por përdorimi i tyre më i njohur dhe më i diskutueshëm është nga ushtria, për zbulim, vëzhgim dhe sulme të synuara. Që nga sulmet terroriste të 11 shtatorit, Shtetet e Bashkuara në veçanti kanë rritur ndjeshëm përdorimin e dronëve. Ato përdoren kryesisht për mbikëqyrje në zona dhe terrene ku trupat nuk janë në gjendje të shkojnë në mënyrë të sigurt. Por ato përdoren gjithashtu si armë dhe janë vlerësuar në vrasjen e militantëve të dyshuar. Përdorimi i tyre në konfliktet aktuale dhe mbi disa vende ka ngritur pikëpyetje në lidhje me etikën e këtij lloji të armatimit, veçanërisht kur rezultojnë në vdekje civile, qoftë për shkak të të dhënave të pasakta ose për shkak të afërsisë së tyre me një “objektiv”.

Teknologjia UAV ka inkurajuar industritë në praktika të ndryshme. Megjithatë, me të gjitha avantazhet vijën edhe disa disavantazhe. Megjithëse dronët synojnë përsosmërinë, ato nuk janë krijuar në mënyrë të përsosur.

Ruajtja e mjedisit sigurt - UAV-të përdoren në dukuri të shumta për shkak të avancimit të tyre në siguri. Me aftësitë e tyre të telekomandimit, dronët monitorojnë vendndodhjet, komunikojnë rreziqet e mundshme dhe njoftojnë kushtet kërcënuese, të tilla si rafineritë e naftës dhe gazit, tubacionet dhe pargjet e ndezjeve. Jo vetëm kjo, “Teknologjia Dron” përdoret edhe në ushtri gjatë periudhave me rrezik të lartë. Karakteristikat e tyre u lejojnë atyre të marrin të dhëna në kohë reale për të krijuar dhe ruajtur një mjedis të sigurt.

Teknologjia e kursimit të kostove - Ndërsa përdorimi i dronëve bëhet më i gjerë, çmimet e tyre gjithashtu drejtohen drejt të qenit më miqësorë ndaj xhepit. Njerëzit tani blejnë dronë jo vetëm për praktikë e tyre industriale, por edhe për të përmbushur pasionin e pajisjes së tyre të teknologjisë. UAV-të nuk janë më

Gjatë periudhës ndërmjet luftës, zhvillimi dhe testimi i avionëve pa pilot vazhdoi. Në 1935 britanikët prodhuan një numër avionësh të kontrolluar me radio që do të përdreshin si objektiva për qëllime stërvitore. Mendohet se termi “dron” filloi të përdoret në këtë kohë, i frymëzuar nga emri i një prej këtyre modeleve, DH.82B “Queen Bee”.

Dronët, avantazhet dhe disavantazhet



vetëm për ushtrinë, autoritetet ligjore apo elitën. Meqenëse UAV-të marrin përsipër disa fuqi punëtore, automjete dhe aktivite operative në përdorime komerciale, shumë kosto janë ruajtur. Për shembull, një dron është më ekonomik për t'u blerë dhe për karburant sesa aeroplanët. Përveç kësaj, nuk keni nevojë të përdorni shkallë, ashensorë dhe pajisje të tjera të rënda.

Cilësia e imazhit ajror - Me kamerat e tyre me rezolucion të lartë të pajisura me sensorë të nivelit të lartë, UAV-të mund të bëjnë fotografi të shkëlqyera ajrore, video ajrore dhe të grumbullojnë vëllime të mëdha të dhënash të sakta. Të dhënat e marra shndërrohen në Harta 3D dhe Modele 3D të detajuara për një analizë të plotë. Harta 3D është veçanërisht e rëndësishme për zbulimin e çarjeve, dëmtimeve ose elementëve të tjerë të rreziqshëm në zonat e fatkeqësive. Dronët, kur kombinohen së bashku me imazhe me rezolucion të lartë ose aftësi video 4K, janë të njohur për transmetimin e drejtpërdrejtë të ngjarjeve të rëndësishme si argëtimi, çështjet personale, politike dhe globale.

Saktësi - UAV-të përshtatin GPS (Sistemi i Pozicionimit Global) në softuerin e tyre, kjo është arsyeja pse ato mund të programohen dhe udhëzohen saktësisht në vende specifike. Për shembull, në Bujqësinë Precize, një Avion Dron përdoret për të kryer shumë detyrime bujqësore si spërkatja e pesticideve, identifikimi i barërave të këqija, monitorimi i mbarëvajtjes së të korrave, dëmtimi i të korrave, vlerësimi i të korrave, analiza e tokës në terren, monitorimi i ujtitjes etj. Kjo veçori e saktësisë përmes GPS kursen kohë dhe shpenzime për fermerët.

Përdorim dhe kontrollim të lehtë

- Përparimi i rregullt në teknologjinë e kontrollit të dronëve u lejon operatorëve të vendosin dhe të përdorin me shpejtësi dronët edhe me një sfond teknik relativisht minimal. Me një gamë të gjerë dronësh me kosto të ulët të disponueshme për disa qëllime, dronët janë të hapur për një spektër të gjerë operatorësh. Mjetet ajrore pa pilot (UAV) kanë një gamë më të gjerë lëvizjeje, fluturojnë më poshtë në të gjitha drejtimet dhe mund të lundrojnë pa mundim kur krahasohen me një avion me ekuipazh.

Siguria - Një tjetër avantazh që peshon të mirat dhe të këqijat e një droni është siguria e përqendruar rreth tyre.

Me lejet dhe licencat përkatëse, operatorët e dronëve mund të përdorin një Sistem Aeroplani Pa pilot (UAS) për të ofruar siguri dhe mbikëqyrje për organizatat private, vendet e mundshme dhe shpenzime të tjera. Dronët gjithashtu mund të grumbullojnë informacion të besueshëm nga katastrofat natyrore për të mbështetur përpjekjet e sigurisë dhe rimëkëmbjes.

Minimizim rrezikun dhe rreziqet në shëndet - Me mbështetjen e një droni, rreziqe të shumta si lartësia, era, moti dhe rrezatimi që ishin vuajtur më parë nga anëtarët e ekuipazhit janë zëvendësuar me alternativa më të qëndrueshme dhe më të sigurta. Dronët lehtësojnë inspektimet e drejtpërdrejta dhe të sigurta të konstruksioneve të larta dhe të komplikuar si rafineritë e naftës dhe gazit, pargjet e flakëve dhe tubacionet.

Marrja e të dhënave dhe e detajeve të hollësishme - Shumë modele dronësh janë hedhur në treg me kapacitete për shmangien e pengesave. Ato mund të operojnë mjaft afër ndërtimeve dhe kjo i inkurajon ata të kapin të dhëna të sakta. Ata kapin imazhe me rezolucion të lartë ose video 4K që zbulojnë në mënyrë eksplicite çarje, dëmtime, tela të zhvendosur dhe defekte shtesë që ne nuk mund t'i zbulojmë me syrin tonë të lirë. UAV-të lejojnë marrjen e të dhënave të plota pa rrezikuar anëtarët e ekuipazhit të inspektimit të kompanisë.

Fleksibilitet për inspektime të shpejta - Meqenëse dronët vijnë me specifika të ndryshme, disa mund të ofrojnë Inspektime në lartësi të lartë ose të ulët. Shkathtësia e këtyre karakteristikave i fuqizon klientët të personalizojnë mjetet me lehtësi për projektet e tyre. Dronët janë të përshtatshëm si për skenarë të rregullt ashtu edhe për emergjencë. Industria e Ndërtimit u përmbahet këtyre avantazheve, veçanërisht ndërtuesit për Inspektimet e Tavanëve. Dronët mund të kryejnë role të shumta, të tilla si kapja e fotografive, videoe, imazheve termike me cilësi të lartë, etj. Këto të dhëna më pas transmetohen dhe përpunohen menjëherë, në krahasim me metodën konvencionale që kërkon kohë.

Arritja e zonave të rreziqshme - UAV-të e bëjnë marrjen e të dhënave efikase nga vende të vështira për t'u arritur një rrugëdalje për profesionistët e industrisë. Është alternativa më e përshtatshme për të kapërcyer kufizimet e metodave tradicionale në lidhje me sigurinë e punëtorëve,

veçanërisht në situata të rreziqshme si monitorimi i rrezatimit, inspektimi i linjave të tensionit të lartë. Dronët gjithashtu lejojnë një qasje më kosto-efektive ndaj inspektimeve të këtyre vendeve.

DISAVANTAZHET

Privatësia - Ndërsa përfitimet e dronit janë të pafundme, teknologjia e dronëve ka disa anë negative. UAV-të mund të bien shpejt pre e manipulimit dhe të shkelin privatësinë e një grupi ose individi. Megjithëse shumë dëshirojnë të përdorin dronët për të ruajtur sigurinë, ai mund të shkelë liri të shumta individuale në emër të sigurisë publike.

Pasiguria legjislative - Përdorimi i Sistemeve të Avionëve Pa pilot (UAS) është bërë i përhapur; megjithatë, ligji është ende në zhvillim, duke pasur parasysh se është një teknologji e re në industri. Praktikë specifike të instaluar për dronët e vegjël zbatohen gjithashtu për aplikacionet komerciale dhe rekreative, por janë ende të paqarta në disa dimensionet. Rregullat për rregullimin e lëvizjes së dronëve dhe mbrojtjen e pronës nga shkelja ajrore janë ende në përgatitje; Kështu, teknologjia UAV funksionon në një zonë gri gjyqësore. Ekzistojnë fërkime të shumta midis rregulloreve qeveritare dhe çdo ligji shtetëror ose qyteti për të menaxhuar të drejtat e pronës në hapësirën ajrore, për shkak të të cilave operatorët e dronëve mund të shkelin rregullat që nuk i dinin.

Siguria - Siguria është një element themelor për t'i dhënë përparësi kur përdorni teknologjinë e dronëve. UAV-të e pajisura me sensorë të cilësisë së lartë njohin përplasjet e mundshme dhe krijojnë në mënyrë të sigurt rrugën rreth tyre, duke i bërë ato një tipar domethënës. Këto kapacitete dronësh duhet të ngjajnë me ato të navigatorëve të avionëve të drejtuar. Është e lavdërueshme të punësosh ofrues profesionistë të shërbimit të dronëve që mund të operojnë një dron ajror pa e përplasur atë. Dronët që operojnë në rajone shumë të populluara kanë një rrezik të përforcuar të goditjes ose dëmtimit në tokë, kryesisht për shkak të mosfunksionimit të sistemit ose hakerimit.

Probleme të softuerit ose keqfunksionim - Ka pasur më parë shumë dronë që kanë qëlluar me armë të njerëzit e thjeshtë, duke gjeneruar një sasi të konsiderueshme viktimash, lëndimesh dhe

dëmsh për shkak të keqfunksionimeve ose gabimeve të softuerit. Aksidentet me dron godasin sigurinë e personelit tjetër ushtarak gjithashtu. Dronët janë ende në proces përmirësimi për të kufizuar aksidentet ose rreziqet që mund të ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e jetëve njerëzore.

Të cenueshëm nga kafshët - Dronët janë të ndjeshëm ndaj sulmeve të kafshëve të egra dhe ndonjëherë janë gjithashtu të rreziqshëm për natyrën. Është e mundur që kur një operator droni po fluturon në një domen me një numër të konsiderueshëm kafshësh të egra, ata të përplasen me një pemë ose ndoshta të konfliktohen me një kafshë të cenueshme. Zogj të mëdhenj fluturues si shqiponjat i sulmojnë rregullisht dhe madje i kapin dronët që veprojnë në hapësirën e tyre për të marrë të dhëna vendimtare.

Spiunimi - Shumë shkelës përdorin dronët si një strategji për të synuar viktimat e tyre dhe për të mbajtur një gjurmë mbi to. Zhurmat flagrante të helikës nuk janë më shqetësuese dhe janë të padukshme, duke u mundësuar kriminelëve të pushtojnë privatësinë e dikujt. Shumë dronë të pajisur me sensorë termikë dhe të natës identifikojnë shenjat e jetës dhe synojnë në mënyrë efikase ato që janë aktualisht me interes nga spiuni. Meqenëse UAV-të mund të kapin të dhëna të sakta, ata mund të regjistrojnë zakone të rregullta dhe të njohin aktivitetet të dyshimta pa leje.

Të lehtë për t'u hakuar - Një dobësi thelbësore për rritjen e teknologjisë së dronëve është cenueshmëria e saj. Hakerët mund të sulmojnë shpejt sistemin e kontrollit qendror të një droni dhe të bëhen kontrolluesi origjinal i dronit. Sistemi parësor i kontrollit përfshin njohuri të rëndësishme, thelbësore që hackerët të shmangin pa ndërgjegjësimin e operatorit fillestar. Hakerët mund të marrin informacione private, të korruptojnë ose dëmtojnë skedarët dhe të nxjerrin të dhëna tek palët e treta të paautorizuara.

Të varur nga moti - Dronët janë më të prekshëm ndaj kushteve të motit kur krahasohen me avionët tradicionalë. Për shembull, nëse kushtet klimatike janë të pafavorshme, UAV nuk do të manovrojë siç duhet ose nuk do të mbledhë të dhëna ose imazhe të besueshme. Megjithatë, ka drone të disponueshme që janë më të qëndrueshëm dhe mund t'i rezistojnë me sukses goditjeve të erës.

Njohuri dhe aftësi - Siç u diskutua më herët, nëse dikush kërkon marrjen e të dhënave të sakta dhe me cilësi të lartë, ata duhet të zotërojnë grupin e aftësive të kërkuara. Ky specifikim do të tregonte se një fermer mesatar do të kërkonte trajnim gjithëpërfshirës ose një ofrues shërbimi të palëve të treta me dron për të kapur, përpunuar dhe analizuar të dhënat bujqësore. Me zgjerimin e operatorëve në industri, kostot e dronëve dhe shpenzimet e burimeve shoqërore të tij do të ulen gradualisht.

Shpejtësia e transferimit të të dhënave është e ulët - Një nga pengesat në zgjerimin e teknologjisë së dronëve në bujqësi është shpejtësia e transmetimit të të dhënave, që disa supozojnë se mund të jetë një javë. Nëse koha e nevojshme për shpërndarjen e të dhënave rezultojnë në një mos-produktivitet të fermerëve dhe dëmtim të plehrave, të korrave ose pesticideve, funksionimi i dronit në fund do të ishte një humbje. Kështu, nëse shpejtësia e transferimit të të dhënave është e ngadaltë, vuajtjet dhe dëmtimet mund të ndodhin në atë periudhë, duke ndjekur të gjitha përpjekjet që shkojnë dëm.

(vijon në numrin e ardhshëm)

MINISTRAT E JASHTËM TË NATO-S TRAJTOJNË LUFTËN E PRESIDENTIT PUTIN KUNDËR UKRAINËS

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Vrasja e civilëve është një krim lufte

Stoltenberg: Aleatët e NATO-s po mbështesin hetimet, edhe nëpërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Gjykatës Ndërkombëtare Penale

Takimi i Ministrave të Jashtëm të NATO-s në Bruksel, këtë javë (6-7 prill 2022), trajtoi pushtimin brutal dhe të paprovokuar të Ukrainës nga Presidenti Putin. Aleatët po rritin mbështetjen e tyre për të drejtën e Ukrainës për t'u mbrojtur, përfshirë armët antitank, sistemet e mbrojtjes ajrore dhe pajisje të tjera, si dhe rritjen e ndihmës humanitare dhe ndihmës financiare.

“Ne nuk kemi parë asnjë tregues se presidenti Putin ka ndryshuar ambicien e tij për të kontrolluar të gjithë Ukrainën dhe gjithashtu për të rishikuar rendin ndërkombëtar, kështu që ne duhet të jemi të përgatitur për një afat të gjatë”, -tha ai. Ai shtoi: “Ne duhet të mbështesim Ukrainën, të mbajmë sanksionet tona dhe të forcojmë mbrojtjen dhe parandalimin tonë”, -ndërsa hapi takimin dyditor të ministrave të Jashtëm, të mërkurën (6 prill 2022), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Moska nuk heq dorë nga ambiciet e saj në Ukrainë. Tani shohim një lëvizje të konsiderueshme të trupave larg Kievit, për t'u rigrupuar, riarmatosur dhe rifurnizuar, dhe ata e zhvendosin fokusin e tyre në lindje”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg edhe një ditë më parë, më 5 prill 2022. “Synimi dhe vrasja e civilëve është një krim lufte. Të gjitha faktet duhet të vërtetohen dhe të gjithë ata që janë përgjegjës për këto mizori duhet të sillen para drejtësisë”, -shtoi Stoltenberg, duke komentuar imazhet e tmerrshme të civilëve të vrarë në Bucha dhe vende të tjera.

Takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s iu bashkuan homologët e tyre nga Ukraina, Finlanda, Suedia, Gjeorgjia dhe Bashkimi Europian, dhe nga partnerët e NATO-s në Azi-Paqësor, Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Republika e Koresë. “Në një kohë kur fuqitë autoritare po e shtyjnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, është edhe më e rëndësishme që demokracitë të qëndrojnë së bashku dhe të mbrojnë vlerat tona”, -tha Stoltenberg.

Ministrat e Jashtëm aleatë diskutuan gjithashtu zhvillimin e Konceptit të ardhshëm Strategjik të NATO-s, për të udhëhequr përshtatjen e Aleancës me realitetin e ri të sigurisë globale. Ata gjithashtu miratuan një Kartë që përcakton se si Përsheptuesi i ri i Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut (DIANA) do të ndihmojë në shfrytëzimin e inovacionit transatlantik.

Aleatët të vendosur të ofrojnë mbështetje të mëtejshme për Ukrainën

Në takimin e tyre dyditor, të zhvilluar në selinë e NATO-s në Bruksel, ministrat e Jashtëm të Aleancës trajtuan “luftën brutale në Ukrainë” të Presidentit Putin. “Të gjithë kemi parë imazhet e tmerrshme të civilëve të vrarë në Bucha dhe vende të tjera, kontrolluar



nga ushtria ruse deri pak ditë më parë”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. “Ky është brutaliteti i padurueshëm që Europa nuk e ka dëshmuar në shumë dekada”, -vijoi ai. “Shënjestrimi dhe vrasja e civilëve është një krim lufte. Të gjitha faktet duhet të vërtetohen dhe të gjithë ata që janë përgjegjës për këto mizori duhet të dalin para drejtësisë. Ndërkohë që aleatët e NATO-s po mbështesin hetimet, edhe nëpërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Gjykatës Ndërkombëtare Penale, nga ana tjetër janë Forcat e armatosura të Ukrainës që po bëjnë rezistencë të ashpër, rimarrin territore nga pushtuesit rusë dhe po e detyrojnë Rusinë të ndryshojë planet e saj të luftës. Por Moska nuk po heq dorë nga ambiciet e saj në Ukrainë. Tani shohim një lëvizje të konsiderueshme të trupave larg Kievit, për t'u rigrupuar, riarmatosur dhe rifurnizuar dhe për ta zhvendosur fokusin e tyre në lindje”, -tha ai dhe shpjegoi se çfarë mund të pritej në javët e ardhshme. “Ne presim një shtytje të mëtejshme ruse në Ukrainën lindore dhe jugore. Përpjekja për të marrë të gjithë Donbasin dhe për të krijuar një urë tokësore për në Krimenë e pushtuar. Pra, kjo është një fazë vendimtare e luftës”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ndërsa Ukraina po përballet me këtë ofensivë të re. Ai tha se është e rëndësishme të diskutohet se çfarë do të bëjmë më shumë, por gjithashtu ai tha se Aleatët janë të vendosur të ofrojnë mbështetje të mëtejshme për Ukrainën, përfshirë armët antitank, sisteme të mbrojtjes ajrore dhe pajisje të tjera. Aleatët kanë rritur gjithashtu ndihmën humanitare dhe ndihmën financiare”, -raportoi ai për mediat, por ajo që shtoi Stoltenberg ishte se: “NATO do të kërkojë gjithashtu të ofrojë ndihmë për sigurinë kibernetike dhe pajisje për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet nga

kërcënimet kimike dhe biologjike”.

Kërcënimet rajonale dhe më gjerë

E ndërsa lufta në Ukrainë vazhdon, Jens Stoltenberg përmendi partnerët e tjerë të NATO-s, të cilët janë të prekshëm ndaj kërcënimeve dhe ndërhyrjeve ruse, duke shtuar këtu edhe vende si Ballkani Perëndimor dhe Bosnje Hercegovina. “Unë pres që ne gjithashtu të vendosim të bëjmë më shumë për partnerët e tjerë të NATO-s, të cilët janë të prekshëm ndaj kërcënimeve dhe ndërhyrjeve ruse, përfshirë Gjeorgjinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Duke rritur mbështetjen tonë politike dhe praktike, ne mund t'i ndihmojmë partnerët tanë të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre dhe parandalojnë çdo agresion në të ardhmen”, -nënvizoi Stoltenberg.

Në ditën e dytë, takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s iu bashkua edhe ministri i Jashtëm ukrainas Dmytro Kuleba. Ai informoi për zhvillimet më të fundit, përfshirë negociatat e Kievit me Moskën. Finlanda, Suedia, Gjeorgjia dhe Bashkimi Europian, ishin gjithashtu pjesëmarrës në tryezën e bisedimeve. E ndërsa kjo krizë ka implikime globale, të cilat na shqetësojnë të gjithëve, bisedimeve të ministerialit iu bashkuan edhe partnerët e tjerë të NATO-s në Azi-Paqësor, siç janë Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Republika e Koresë.

“Ne shohim se Kina nuk ka qenë e gatshme të dënojë agresionin e Rusisë dhe i është bashkuar Moskës për të vënë në pikëpyetje të drejtën e kombeve për të zgjedhur rrugën e tyre. Në një kohë kur fuqitë autoritare po e shtyjnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, është edhe më e rëndësishme që demokracitë të qëndrojnë së bashku dhe të mbrojnë vlerat tona”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

Aleatët ranë dakord për të thelluar bashkëpunimin e NATO-s me partnerët në Azi-Paqësor, përfshirë në fusha të tilla si kontrolli i armëve, kibernetikë, luftën hibride dhe teknologji. “Duke punuar më ngushtë së bashku do të na bëjë të gjithëve më të mbrojtur dhe më të sigurt”, -tha shefi i NATO-s. Aleatët diskutuan gjithashtu punën për të zhvilluar Konceptin e ardhshëm Strategjik të NATO-s në kohë për Samitin e Madridit në qershor. “Ai do ta drejtojë Aleancën ndërsa ne i përshtatemi një realiteti të ri sigurie. Ai do të trajtojë implikimet e veprimeve agresive të Rusisë dhe marrëdhëniet tona të ardhshme me Moskën”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ai shtoi se çka është gjithashtu e rëndësishme është se, për herë të parë, Koncepti i ardhshëm Strategjik i NATO-s, do të duhet të marrë parasysh ndikimin në rritje të Kinës dhe politikat shtrënguese në skenën globale, të cilat përbëjnë një sfidë sistematike për sigurinë tonë dhe për demokracitë tona. “Koncepti ynë i ardhshëm strategjik duhet gjithashtu të marrë në konsideratë ndryshimet klimatike, terrorizmin dhe teknologjitë në zhvillim dhe përçarës. Në Samitin tonë të vitit të kaluar, ne ramë dakord të krijojmë Fondin e Inovacionit të NATO-s dhe një Përsheptues i Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut – DIANA, prandaj në këtë takim ministrat miratuan Kartën e DIANA-s, duke përcaktuar se si do të funksionojë”, -theksoi Jens Stoltenberg. Ai informoi gjithashtu se “Karta DIANA”, do të përfshijë një rrjet prej rreth 60 vendesh inovacioni në Europë dhe Amerikën e Veriut. “Mundësimi i NATO-s për të zhvilluar dhe testuar aftësi të reja për mbrojtjen tonë”, -tha ai.

“Gjithsej, gjurma fillestare do të mbulojë 20 vende të NATO-s, duke

përfaqësuar një përpjekje të vërtetë transatlantike dhe ne presim që ajo të vazhdojë të zgjerohet në të ardhmen. DIANA do të punojë me akademinë dhe sektorin privat, duke përfshirë bizneset e reja dhe sipërmarrësit, në mënyrë që aleatët, pavarësisht nga madhësia ose vendndodhja e tyre, të mund të shfrytëzojnë teknologjinë më të mirë dhe t'i mbajnë njerëzit tanë të sigurt”, -tha Sekretari i Përgjithshëm.

Takimi i ministrave të Jashtëm të NATO-s, ishte një moment historik i rëndësishëm ndërsa Aleanca vazhdon të përshtatet për të ardhmen.

Cilat janë perceptimet aleate për sigurinë, mbrojtjen dhe NATO-n

Në vitin 2021, NATO vazhdoi të monitoronte perceptimet e qytetarëve aleatë mbi mbrojtjen dhe sigurinë, duke përcaktuar mbështetjen për metrikat kryesore, përfshirë mbrojtjen kolektive, lidhjen transatlantike dhe anëtarësimin në NATO. Çdo valë e të dhënave të anketës në gjithë Aleancën publikohet në Raportin Vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm, (në këtë rast u bë publik javën e parë). Ky raport i zgjeruar përfshinte të dhëna të prirjeve për njohjen me NATO-n, mbështetjen për shpenzimet e mbrojtjes dhe perceptimet mbi ndryshimet klimatike dhe sigurinë. Periudha e punës në terren për këtë studim ishte 12 nëntor – 2 dhjetor 2021 (përpara pushtimit të Ukrainës nga Rusia).

Në këtë studim mbulimi ishte për 30 aleatë të NATO-s, ku popullsia e përgjithshme ishte mbi 18 vjeç;

Madhësia e kampionit ishte se në të gjitha vendet e anketuara në internet u arrit një kampion prej të paktën 1,000 të anketuar për çdo vend. Në vendet me intervista përballë, u intervistuan të paktën 500 individë për çdo vend. Studimi thotë se në total janë realizuar 28 909 intervista. Kurse metodologjia e përdorur ishte nëpërmjet intervistave online, kuotat e aplikuara sipas gjinisë, moshës dhe rajonit. Në Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut intervistat u kryen përmes telefonit. Studimi thotë se të gjitha të dhënat janë ponderuar sipas statistikave më të fundit të popullsisë. Rezultatet për totalin e NATO-s marrin parasysh madhësinë e popullsisë së secilit vend. Periudha e punës në terren ishte 12 nëntor – 2 dhjetor 2021, ndërsa “marzhi i gabimit”, ishte se Anketa përdor kampionimin joprobabil, tregu dhe marzhi tregues i gabimit prej +/- 3 %. Të dhënat e tendencës sipas studimit tregojnë se, të dhënat e vitit 2020 bazohen në intervistat e kryera nga kompania “Kantar”, midis 28 517 të rriturve në 30 vendeve anëtare të NATO-s, midis 5 dhe 23 nëntorit 2020. Të dhënat e grafikuara të vitit 2019 bazohen në anketat e 28 752 të rriturve, të kryera në nëntor 2019 nga “Populus”, në 29 vende anëtare të NATO-s dhe Maqedoninë e Veriut.

"UDHËHEQJA AMERIKANE KA QENË E JASHTËZAKONSHME DHE ËSHTË E DOMOSDOSHME"

Sekretari i Përgjithshëm mirëpret Sekretarin e Shtetit të SHBA-ve në selinë e NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg u takua me Sekretarin e Shtetit të SHBA-ve Antony Blinken, më 6 prill 2022, përpara takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Sekretarin Blinken për udhëheqjen e tij personale në çdo fazë të krizës mbi Ukrainën dhe për përpjekjet e tij të palodhura për t'u konsultuar dhe koordinuar me aleatët e NATO-s. Ai gjithashtu e falënderoi atë për angazhimin e fuqishëm të Shteteve të Bashkuara ndaj Aleancës, siç tregohet veçanërisht nga njëqind mijë trupat amerikane tani në Europë. "Udhëheqja

amerikane ka qenë e jashtëzakonshme dhe është e domosdoshme", -tha z. Stoltenberg. Në takimin e tyre gjatë dy ditëve 6-7 prill 2022, ministrat diskutuan se çfarë mund të bëjë më shumë NATO për të mbështetur Ukrainën dhe si të mbështesë partnerët e tjerë të cenusshëm ndaj presionit rus, duke përfshirë Gjeorgjinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Me pjesëmarrjen edhe nga Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Koreja e Jugut, si dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së, ministrat trajtuan gjithashtu shtyrjen në rritje të fuqive autoritare kundër rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla.



DISKUTIME MBI LUFTËN, NË MINISTERIALIN E NATO-S

Stoltenberg: Ajo që bëni çdo ditë, duke iu kundërvënë agresionit rus, frymëzon të gjithë botën

Ministri i Ukrainës Kuleba: Armët i shërbejnë qëllimit të pages

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg mirëpriti ministrin e Jashtëm ukrainas Dmytro Kuleba në selinë e NATO-s, më 7 prill 2022, përpara takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s me pjesëmarrjen e partnerëve. "Ajo që bëni çdo ditë, duke iu kundërvënë agresionit rus, frymëzon të gjithë botën", -tha Sekretari i Përgjithshëm.

Deklarata nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dhe ministri i Punëve të Jashtme të Ukrainës, Dmytro Kuleba
Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg:

"Ministri i Jashtëm Kuleba! Mirë se vini në NATO!"

Është gjithmonë një kënaqësi e madhe t'ju mirëpres këtu dhe më lejoni të filloj duke shprehur se sa shumë e admirojmë guximin tuaj, udhëheqjen tuaj, ju personalisht, por edhe Qeverinë e Ukrainës, popullin e Ukrainës dhe sigurisht, trimërinë dhe guximin e forcave të armatosura të Ukrainës. Ajo që bëni çdo ditë, duke u ngritur kundër agresionit rus, është diçka që frymëzon të gjithë botën.

Siç e dini, aleatët e NATO-s kanë ofruar mbështetje për Ukrainën për shumë vite. Trajnuan dhjetëra mijëra trupa ukrainase dhe tani aleatët po ju ofrojnë pajisje, mbështetje për të mbrojtur të drejtën tuaj për vetëmbrojtje. Një e drejtë e cila është e përfshirë në Kartën e OKB-së dhe është një nevojë urgjente për të mbështetur më tej Ukrainën. Në takimin tonë më vonë me ministrat e Jashtëm të NATO-s, jam i sigurt se do të trajtojmë nevojën për më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore, armë antitank, armë më të lehta, por edhe më të rënda, dhe shumë lloje të ndryshme mbështetjeje për Ukrainën.

NATO ka gjithashtu një përgjegjësi që, natyrisht, të sigurojë dhe mbrojtje të gjithë aleatët. Pra, që nga pushtimi i Ukrainës, ne kemi rritur praninë tonë ushtarake në pjesën lindore të Aleancës dhe ne po sigurohemi që të mos ketë vend për keqkuptime, llogaritje të gabuara në Moskë për gatishmërinë tonë për të mbrojtur të gjithë aleatët.

Ju jeni këtu, na ofroni një mundësi shumë të mirë për t'u ulur me ju, për të dëgjuar vlerësimin tuaj, analizën tuaj dhe së bashku, diskutojmë rrugën përpara, se si mund ta mbështesim më tej Ukrainën. Pra, i dashur, Dmytro, mirë se erdhe. Është mirë që të kemi këtu."

Ministri i Punëve të Jashtme të Ukrainës, Dmytro Kuleba:

"Faleminderit, Jens, që më mirëpritët!"

Erdha në Bruksel për të marrë pjesë në ministerialin e NATO-s dhe për të zhvilluar takime dypalëshe me aleatët. Agjenda ime është shumë e thjeshtë. Ka vetëm tre artikuj në të. Janë armë, armë dhe armë.

Ne kemi besim se mënyra më e mirë për të ndihmuar Ukrainën tani është t'i sigurojë asaj gjithçka të nevojshme për



të frenuar Putinin dhe për të mposhtur ushtrinë ruse në Ukrainë, në territorin e Ukrainës, në mënyrë që lufta të mos përhapet më tej. Në muajin e fundit, në javët e fundit ushtria ukrainase dhe i gjithë kombi ukrainas ka treguar se ne dimë të luftojmë. Ne dimë si të fitojmë. Por pa furnizime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme të të gjitha armëve të kërkuara nga Ukraina, këto fitore do të shoqërohen me sakrificë të mëdha.

Sa më shumë armë të marrim dhe

sa më shpejt të mbërrijnë në Ukrainë, aq më shumë jetë njerëzore do të shpëtohen. Sa më pak qytete dhe fshatra do të shkatërrohen dhe nuk do të ketë më "Buchas". Ky është mesazhi im për aleatët. Është shumë e thjeshtë. U bëj thirrje të gjithë aleatëve që të lënë mënjane hezitimet e tyre. Ngurrimi i tyre për t'i ofruar Ukrainës gjithçka që i nevojitet. Sepse, sado e çuditshme të duket, sot armët i shërbejnë qëllimit të paqes. Faleminderit!"

"BANDA E VËLLEZËRVE DHE MOTRAVE"

Admiral Bauer, mesazh trupave aleate në 73-vjetorin e themelimit të NATO-s

Të hënë, më 4 prill 2022, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s u dërgoi një mesazh trupave aleate në përkujtim të 73-vjetorit të themelimit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Në mesazhin e tij admiral Bauer vlerësoi 3.2 milionë burrat dhe gratë me uniformë për punën që bëjnë për të mbajtur qytetarët aleatë të sigurt. Së bashku, ata formojnë një "bandë vëllezërish dhe motrash" unike, të ndarë nga oqeanet, të bashkuar nga vendosmëria e tyre. Mesazhi i Adminalit Bauer u shoqërua me muzikë nga "SHAPE International Band".



4 PRILL - SHËNOHET DITA E NATO-S

Paul - Henri Spaak: Aleanca Atlantike lindi nga nevoja për të mbrojtur veten

fundit, vlerat tona themelore nuk kanë ndryshuar, dhe as angazhimi i aleatëve të NATO-s për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin. Lidhja mes Europës dhe Amerikës së Veriut është më e fortë se kurrë. Së bashku në NATO, ne do të vazhdojmë të mbajmë një miliard njerëzit tanë të sigurt dhe të lirë."

Ndërkohë NATO e de-klasifikuar publikoi: "NATO: Një histori në pamje të çastit për të shënuar Ditën e NATO-s". Me 73 foto tani, ekspozita do të shtohet çdo vit me foto të reja. Një votim publik do të bëhet në fund të vitit në kanalet e mediave sociale të NATO-s për të përcaktuar foton më të mirë.

Historia nëpërmjet fotove: Për më shumë se 70 vjet, NATO ka bashkuar aleatët nga Europa dhe Amerika e Veriut, jo vetëm në një pakt ushtarak për të mbrojtur njëri-tjetrin kundër çdo kërcënimi, por edhe në një Aleancë të vlerave të përbashkëta, bashkëpunimit miqësor dhe unitetit transatlantik.

Me kalimin e viteve, fotografët në të gjithë

NATO-n kanë bërë miliona fotografi që dokumentojnë këtë bashkëpunim, nga sallat vezuluese të samiteve historike deri te llogoret me baltë të stërvitjeve ushtarake. Shumë nga këto foto janë formale dhe institucionale, duke treguar shtrëngime duarsh dhe takime zyrtare. Por herë pas here, fotografi ka kapur një moment të sinqertë njerëzor, spontanitetit dhe madje bukurie.

Koleksioni i paraqitur me 73 foto tregon një foto, nga çdo vit i historisë së NATO-s. Këto fotografi ofrojnë pamje të momenteve kalimtare: ushtarë që ndajnë një meze të lehtë në periferi të një stërvitjeje ushtarake, civilë që bëjnë banja dielli pranë automjeteve të blinduara, aleatë dhe miq që punojnë krah për krah. Të marra së bashku, ato tregojnë një anë më joformale dhe të rastësishme të NATO-s, momentet e vogla që janë grumbulluar mbi shtatë dekada për të krijuar një Aleancë të fortë dhe të bashkuar.



“Bërja e teknologjive miqësore me klimën më gjerësisht të disponueshme do të na ndihmojë të arrijmë objektivat afatgjata të klimës të BE-së dhe të inkurajojmë vendet jashtë Europës që të reduktojnë gazin e tyre F dhe përdorimin e substancave që shkatërrojnë ozonin gjithashtu”.



Komisioni European ka propozuar sot dy rregullore të reja për të kontrolluar më fort gazet serrë të fluorizuar (F-gazet) dhe substancat që shkatërrojnë ozonin (ODS). Miratimi i këtyre rregulloreve do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt kufizimit të rritjes së temperaturës globale në përputhje me Marrëveshjen e Parisit. Propozimi i gazit F do të kontribuojë gjithashtu në reduktimin e emetimeve me të paktën 55% deri në vitin 2030 dhe për ta bërë Europën neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050. Të dy propozimet së bashku mund të sjellin një reduktim total të emetimeve të gazit serrë të BE-së prej 490 Mt (CO₂ ekuivalente) deri në vitin 2050. Për krahasim, kjo është pak më e lartë se emimet totale vjetore të gazeve serrë të Francës në vitin 2019.

Frans Timmermans, Zëvendës-Presidenti Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjelbër Europiane tha: “Për dekada të tëra, Bashkimi European ka pasur politikën më ambicioze në botë për gazrat e fluorizuar dhe substancat që shkatërrojnë ozonin. Ndërsa ligjet ekzistuese kanë qenë të suksesshme, shkenca na nxit të shkojmë më tej dhe më shpejt tani. Bërja e teknologjive miqësore me klimën më gjerësisht të disponueshme do të na ndihmojë të arrijmë objektivat afatgjata të klimës të BE-së dhe të inkurajojmë vendet jashtë Europës që të reduktojnë gazin e tyre F dhe përdorimin e substancave që shkatërrojnë ozonin gjithashtu”.

Gazrat F dhe ODS janë gazra serrë shumë të fuqishëm, të prodhuar nga njeriu, që kontribuojnë në ngrohjen globale kur lëshohen në atmosferë, shpesh disa mijëra herë më të fortë se dioksidi i karbonit (CO₂). ODS dëmton shtresën e ozonit që mbron Tokën nga rrezatimi i rrezikshëm ultravjollcë nga dielli. Të dy llojet e grupeve të substancave kanë ose përdoren për të pasur aplikime praktike në jetën e përditshme, për shembull në ftohje, klimatizim, izolim, mbrojtje nga zjarri, linja elektrike dhe si shtytës aerosol. Ndërsa legjislati ekzistues i BE-së tashmë ka kufizuar ndjeshëm përdorimin dhe emimet e këtyre gazeve, rregulloret e propozuara sot do të reduktojnë edhe më tej emimet dhe do të ofrojnë stimuj për të përdorur alternativa miqësore me klimën.

Propozim për një rregullore të re për gazin F

Në nivel të BE-së, gazrat F përbëjnë aktualisht 2,5 % të emetimeve totale të GS (gazit serrë). Propozimi i përfortuar i gazit F do të kursejë ekuivalentin e 40 milionë tonëve të emetimeve të dioksidit të karbonit (CO₂) deri në vitin



Marrëveshja e Gjelbër: Ulja graduale e gazeve serrë të fluorizuar dhe substancave që shkatërrojnë ozonin



2030, përtej reduktimit të pritshëm sipas legjislati aktual, duke arritur kursime shtesë totale ekuivalente me 310 milionë tonë CO₂ deri në vitin 2050.

Ofrimi i ambicieve më të larta: Propozimi do të shtrengonte sistemin e kuotave për hidrofluorokarburet (ulja në fazën HFC), duke reduktuar ndikimin e mundshëm klimatik të HFC-ve të reja që vijnë në tregun e BE-së me 98% midis 2015 dhe 2050. Ai gjithashtu prezanton kufizime të reja për të siguruar që gazrat F do të përdoren vetëm në pajisjet e reja ku nuk ka alternativa të përshtatshme. Për shembull, SF₆, gazi serrë më i fuqishëm, do të hiqet

gradualisht në të gjitha pajisjet e reja për transmetimin elektrik (“çelës”) deri në vitin 2031.

Përmirësimi i ekzekutimit dhe zbatimit: Propozimi do ta bënte më të lehtë për autoritetet doganore dhe mbikëqyrëse kontrollin e importeve dhe eksporteve, duke goditur tregtinë e gazrave dhe pajisjeve të paligjshme F. Për më tepër, dënimet do të bëhen më të ashpra dhe më të standardizuara. Sistemi i kuotave do të kufizohet vetëm për tregtarët e vërtetë të gazit nëpërmjet rregullave më të rrepta të regjistrimit dhe vendosjes së një çmimi fiks të kuotave. Numri

i inxhinierëve të kualifikuar për të trajtuar pajisje miqësore me klimën në Europë do të rritet pasi shteteve anëtare do t’u kërkohet të zgjerojnë programet e tyre të certifikimit dhe trajnimit për të mbuluar teknologjitë miqësore me klimën që zëvendësojnë ose reduktojnë përdorimin e gazit F.

Monitorim më gjithëpërfshirës: Do të mbulohej një gamë më e gjerë substancash dhe aktivitetesh dhe do të përmirësoheshin procedurat për raportimin dhe verifikimin e të dhënave.

Sigurimi i përputhshmërisë me Protokollin e Montrealit: Propozimi i gazit F do të shfuqizonte disa përjashtime dhe do të sillte uljen e fazës së HFC-së të BE-së plotësisht në përputhje me Protokollin e Montrealit.

Propozim për një rregullore të re ODS

Duke futur masa të reja që synojnë produktet në të cilat ODS-të janë përdorur ligjërisht në të kaluarën, BE-ja dëshiron të parandalojë emimet e barasvlefshme prej 180 milion tonë CO₂ dhe 32 000 tonë emime potenciale që shkatërrojnë ozonin (ODP) deri në vitin 2050.

Ambicie më e lartë: Shumica e kursimeve të emetimeve shtesë do të arriheshin duke kërkuar që ODS të rikuperohet ose të shkatërrohet nga shkumat izoluese kur ndërtesat rinovohen ose prishen.

Drejtimi: Industria dhe autoritetet do të përfitonin nga kursimet e kostos për shkak të një sistemi të modernizuar licencimi dhe përfundimit të kërkesave të vjetërsuara të kuotave dhe regjistrimit.

Përmirësimi i zbatimit dhe monitorimit: Do të ndërmerren masa për të luftuar aktivitetet e paligjshme të ngjashme me ato të propozuara në

Rregulloren për gazin F. Raportimi do të zgjerohej për të mbuluar më shumë substanca dhe aktivitete për të kuptuar më mirë tregtinë e ODS, emimet e tyre dhe çdo rrezik të ardhshëm.

Protokolli i Montrealit i Konventës së Vjenës, mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit u miratua në 1987 dhe vendosi një plan global të largimit nga faza për prodhimin dhe konsumin e rreth 100 substancave që shkatërrojnë ozonin. BE-ja dhe Shtetet Anëtare të saj janë Palë të Protokollit dhe kanë hequr gradualisht grupet e ndryshme të ODS sipas planit.

Në vitin 2016, palët në Protokollin e Montrealit vendosën gjithashtu të rregullojnë një grup gazesh F, hidrofluorokarbure, edhe pse ato nuk dëmtojnë ozonin. Arsyeja për këtë të ashtuquajtur Amendament Kigali ishte një shqetësim serioz në lidhje me përdorimin në rritje të hidrofluorokarbureve dhe ndikimin e tyre klimatik.

BE-ja ka vendosur legjislaton efektiv. Rregullorja aktuale e ODS e KE-së Nr. 1005/2009 në përgjithësi ndalon prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e ODS-ve, duke përjashtuar disa përdorime të specifikuara. Shumë ODS u hoqën nga përdorimi në vite, në Bashkimin European përpara orarit global të rënë dakord sipas Protokollit të Montrealit. Rregullorja ODS gjithashtu shkon përtej Protokollit duke kufizuar tregtinë dhe përdorimin e produkteve dhe pajisjeve me ODS.

Rregullorja aktuale e BE-së për gazet F nr. 517/2014 kërkoi të reduktoje emimet nga gazet serrë të fluorizuar dhe të lehtësonte një marrëveshje globale për të hequr gradualisht hidrofluorokarburet, e cila u miratua me amendamentin e Kigalit në Protokollin e Montrealit në 2019. Gazrat F zakonisht zëvendësoheshin nga ODS-të kur ishin të ndaluara.



“Deri në vitin 2050, aktiviteti ekonomik në Bashkimin European nuk duhet të ndotë më ajrin, ujin dhe mjedisin tonë më gjerë. Propozimet e sotme do të mundësojnë reduktime të rëndësishme të emetimeve të dëmshme që vijnë nga instalimet industriale dhe fermat më të mëdha blegtorale të Europës”.



Modernizimi i rregullave të BE-së për emetimet industriale drejt një tranzicioni afatgjatë të gjelbër

Komisioni European po paraqet propozime për të përditësuar dhe modernizuar Direktivën e Emetimeve Industriale, legjislacionin kyç për të ndihmuar në parandalimin dhe kontrollin e ndotjes. Rregullat e përditësuara do të ndihmojnë në drejtimin e investimeve industriale të nevojshme për transformimin e Europës drejt një ekonomie me ndotje zero, konkurruese dhe neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050. Ato synojnë të nxisin inovacionin, të shpërblejnë fituesit dhe të ndihmojnë në barazimin e kushteve të lojës në tregun e BE-së. Rishikimi do të ndihmojë në sigurimin e sigurisë afatgjatë të investimeve, me detyrimet e para të reja për industrinë që priten në gjysmën e dytë të dekadës.

Rishikimi bazohet në qasjen e përgjithshme të Direktivës ekzistuese të Emetimeve Industriale, e cila aktualisht mbulon rreth 50 000 instalime të mëdha industriale dhe ferma blegtorale intensive në Europë. Këto instalime duhet të jenë në përputhje me kushtet e emetimeve duke aplikuar “Teknikat më të mira të disponueshme” specifike për aktivitetin. Këto teknika përcaktohen së bashku nga industria, ekspertët kombëtarë dhe të Komisionit dhe shoqëria civile. Rregullat e reja do të mbulojnë burime më të rëndësishme të emetimeve, do ta bëjnë lejimin më efektiv, do të zvogëlojë kostot administrative, do të rrisë transparencën dhe do t'i japë më shumë mbështetje teknologjive të reja dhe qasjeve të tjera inovative.

Zëvendës Presidenti Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjelbër Europiane, Frans Timmermans tha: “Deri në vitin 2050, aktiviteti ekonomik në Bashkimin European nuk duhet të ndotë më ajrin, ujin dhe mjedisin tonë më gjerë. Propozimet e sotme do të mundësojnë reduktime të rëndësishme të emetimeve të dëmshme që vijnë nga instalimet industriale dhe fermat më të mëdha blegtorale të Europës. Duke modernizuar kuadrin e emetimeve industriale të Europës, tani ka siguri për rregullat e ardhshme për të udhëhequr investimet afatgjata, për të rritur pavarësinë e energjisë dhe burimeve të Europës dhe për të inkurajuar inovacionin.

Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin Virginijus Sinkevičius tha: “Këto rregulla të reja do t'u mundësojnë impianteve të mëdha industriale dhe blegtorisë intensive të luajnë rolin e tyre në arritjen e objektivit të Marrëveshjes së Gjelbër Europiane dhe ambicies së saj për ndotje zero. Vetëm nga veprimi në fermat blegtorale, përfitimet për shëndetin e njeriut do të arrinin në të paktën 5.5 miliardë euro në vit. Ndryshimet do të krijojnë më shumë vende pune, siç ka treguar me sukses në të kaluarën sektori i eko-inovacionit të BE-së. Masat që



trajtojnë në mënyrë proaktive krizat e ndotjes, klimës dhe biodiversitetit mund ta bëjnë ekonominë tonë më efikase dhe më elastike.”

Përditësimi i një qasjeje të provuar për një periudhë afatgjatë

Pas një konsultimi të gjerë me industrinë dhe palët e interesuara dhe një vlerësim të plotë të ndikimit, kuadri ekzistues do të përmirësohet me masa të reja për të rritur efektivitetin e tij të përgjithshëm. Ndryshimet kryesore përfshijnë:

-Leje më efektive për instalime

Në vend që të vendosen për kufijtë më pak të kërkuar, të teknikave më të mira të disponueshme, siç bëjnë aktualisht rreth 80% e instalimeve, lejimi do të duhet të vlerësojë mundësinë e arritjes së performancës më të mirë. Ai gjithashtu do të shtrëngoje rregullat për dhënie të derogimeve duke harmonizuar vlerësimet e kërkuara dhe duke siguruar një rishikim të rregullt të derogimeve të dhëna.

-Më shumë ndihmë për kryesuesit e inovacionit të BE-së

Si një alternativë ndaj lejeve të bazuara në teknikat më të mira të vendosura, fituesit do të jenë në gjendje të testojnë teknikat e reja, duke përfutur nga lejet më fleksibël. Një Qendër Inovacioni për Transformimin Industrial dhe Emetimet (INCITE) do të ndihmojë industrinë në identifikimin e zgjidhjeve të kontrollit të ndotjes. Së fundi, deri në vitin 2030 ose 2034 operatorët do të duhet të zhvillojnë Plane Transformimi për vendet e tyre për të arritur ambicien e BE-së për ndotjen zero, ekonominë rrethore dhe synimet

e dekarbonizimit për vitin 2050.

Mbështetja e investimeve të ekonomisë rrethore të industrisë. Teknikat e reja më të mira të disponueshme mund të përfshijnë nivelet e performancës së përdorimit të burimeve të detyrueshme. Sistemi ekzistues i Menaxhimit Mjedisor do të përmirësohet për të reduktuar përdorimin e kimikateve toksike.

Sinergjitë midis ndotjes dhe dekarbonizimit. Efienca e energjisë do të jetë një pjesë integrale e lejeve dhe do t'i kushtohet konsideratë sistematike sinergjive teknologjike dhe investimeve midis dekarbonizimit dhe zhdukjes së ndotjes, kur përcaktohen teknikat më të mira të disponueshme.

Rregullat e reja do të mbulojnë gjithashtu më shumë instalime, veçanërisht:

-Më shumë ferma blegtorale intensive në shkallë të gjerë

Sipas rregullave të reja, fermat më të mëdha të gjedheve, derrave dhe shpendëve do të mbulojnë gradualisht: rreth 13% e fermave komerciale të Europës, së bashku përgjegjëse për 60% të emetimeve të amoniakut nga blegtoria në BE dhe 43% të metanit. Përfitimet shëndetësore të këtij mbulimi të zgjeruar vlerësohen në më shumë se 5.5 miliardë euro në vit. Duke qenë se fermat kanë operime më të thjeshta sesa impiantet industriale, të gjitha fermat e mbuluara do të përfitojnë nga një regjim më i lehtë lejesh. Detyrimet që rrjedhin nga ky propozim do të pasqyrojnë madhësinë e fermave si dhe dendësinë e bagëtive përmes kërkesave të përshtatura. Politika e

Përbashkët Bujqësore mbetet një burim kyç i mbështetjes për tranzicionin.

Nxjerrja e mineraleve dhe metaleve industriale dhe prodhimi në shkallë të gjerë i baterive

Këto aktivitete do të zgjerohen ndjeshëm në BE për të mundësuar tranzicionin e gjelbër dhe atë dixhital. Kjo kërkon që teknikat më të mira të disponueshme të përdoren për të siguruar si proceset më efikase të prodhimit ashtu edhe ndikimet më të ulëta të mundshme në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Mekanizmat e qeverisjes të Direktivës që lidhin ngushtë ekspertët e industrisë me zhvillimin e kërkesave mjedisore konsensuale dhe të përshtatura, do të mbështesin rritjen e qëndrueshme të këtyre aktiviteteve në Bashkim.

Së fundi, rregullat e reja do të rrisin transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e lejeve. Përveç kësaj, Regjistri European i Çlirimit dhe Transferimit të Ndotësve do të shndërrohet në një Portal të Emetimeve Industriale të BE-së, ku qytetarët do të jenë në gjendje të kenë akses në të dhënat për lejet e lëshuara kudo në Europë dhe të marrin njohuri mbi aktivitetet ndotëse në rrethinat e tyre të afërta në një mënyrë të thjeshtë.

Hapat e ardhshëm

Propozimi i Komisionit parashikon që Shtetet Anëtare do të kenë 18 muaj kohë për ta përshtatur këtë direktivë në legjislacionin kombëtar, pasi propozimi të miratohet përfundimisht nga Parlamenti European dhe nga Këshilli. Pas kësaj, teknikat më të mira të

disponueshme do të zhvillohen dhe pasi të miratohen nga Komisioni, operatorët industrialë do të kenë katër vjet dhe fermerët tre vjet për të përmbyshur.

Aktivitetet industriale, si prodhimi i energjisë elektrike dhe çimentos, menaxhimi dhe djegia e mbetjeve, dhe rritja intensive e bagëtive, janë përgjegjëse për emetimet e substancave të dëmshme në ajër, ujë dhe tokë. Këto emetime përfshijnë oksidet e squfurit, oksidet e azotit, amoniumin, pluhurin dhe merkurin dhe metale të tjera të rënda. Ndotja e shkaktuar prej tyre mund të çojë në probleme shëndetësore si astma, bronkiti dhe kanceri, dhe gjeneron kosto të mëdha në miliarda euro dhe qindra mijëra vdekje të parakohshme çdo vit. Emetimet industriale dëmtojnë gjithashtu ekosistemet, të korrat dhe mjedisin e ndërtuar.

Falë Direktivës së Emetimeve Industriale, në 15 vitet e fundit emetimet në ajër për shumë ndotës janë reduktuar nga 40% në 75% nga impiantet më të mëdha industriale në Europë dhe fermat intensive të blegtorisë. Emetimet e metaleve të rënda në ujë gjithashtu kanë rënë deri në 50% gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht sukseseve në frenimin e emetimeve, mbi 50 000 instalimet industriale të mbuluara ende përbëjnë rreth 40% të emetimeve të gazeve serrë, mbi 50% të emetimeve totale në ajër të oksideve të squfurit, metaleve të rënda dhe substancave të tjera të dëmshme dhe rreth 30% të oksideve të azotit dhe emetimet e grimcave të imëta në ajër, duke siguruar veprime të mëtejshme.

Me ish-nxënësit e Laknasit, në NATO



NGA SALI ONUZI

Sandokan Manzi

vizaton Emblemën e Nato-s

Shumë kohë para se të merrej zyrtarisht ftesa për anëtarësimin e vendit tonë në NATO, pat filluar edhe informacioni i rrethit të historianëve të rinj të shkollës rreth kësaj tematike. U përgatit një stendë me materiale për NATO-n, një pjesë e të cilave rifreskohej herë pas here. Interesi i nxënësve dhe përfitimi i tyre qe i dukshëm. Ata që e dinin si yll me katër cepa Emblemën e NATO-s, tani nuk çuditeshin kur mësuan se ajo nuk ishte një yll, por një busull. Pyetjet: Pse një busull? Çdo të thotë? Përse blu? Përse një rreth? Sandokan Manzi, një nxënës i talentuar (atëherë në klasën e shtatë) provoi të pikturonte këtë Emblemë dhe ia doli ta vizatonte shumë bukur, duke fituar shumë vizitorë te stenda e katit të dytë. Stenda filloi “të mbushej” me vendet anëtare, me vendet candidate, me organet drejtuese të NATO-s, me emra e foto të personave që e kanë udhëhequr.

Rrethi i historianëve nxiti edhe diskutime për tematika konkrete: Po Shqipëria ç’ marrëdhënie kishte pasur me NATO-n, më 1992, 1994, 1999, 2003, 2008?

Shpresim Zela sjell

flamurin e NATO-s në shkollë

Edhe mjedisi i jashtëm i Shkolles do të zbukurohej për festën e madhe të NATO-s. Por një flamur të madh të NATO-s nuk e kishim. Kur që në mëngjesin të 2 prillit një nxënës po valëviste në oborrin e shkollës një flamur të NATO-s dhe një grup nxënësish i shkonte pas duke brohoritur, e duke i kërkuar “ta mbaj dhe unë, edhe unë”. Krejt spontane. Gjë me të vërtetë e bukur. Pas një xhiroje në oborrin e shkollës, flamurbajtësi e solli flamurin tek dezurni i shkollës për ta vendosur ku duhej. E shoh këtë djalë çapkën, që nuk e fsheh krenarinë për atë që bëri. E takova dhe e falënderova. E pyes kush ishte. “Shpresim Zela i klasës së 7c”, - u përgjigj. Mbiemri “Zela” mu duk i njohur dhe e ngas pyetjen më tej: Nga je ti Zela? “Nga Kukësi, nga Tërshena”, - më thotë. Shpresimi është i biri i Alush Zelës, ushtarak, nënoficer në Forcat Komando, të Forcave tona të Armatosura në Zallherr, që punon me një autoambulancë, me të cilën ka qenë deri ne Irak, ku dhe është dalluar. Ja si vjen historia. Erdhi koha që djemtë e Shqipërisë ta mbajnë në



duart e tyre flamurin e NATO-s, madje të marrin pjesë në veprimtaritë e saj ushtarake e politike, të thonë fjalën e tyre, të votojnë, të dëgjojnë, pse jo edhe të drejtojnë në NATO, në strukturat civile e ushtarake të saj. Apo s’ka djem e vajza Shqipëria!

Po edhe nxënësit dezurn duken më të mobilizuar këto ditë. Mësuesja që ka dezurnin në shkollë, Dila Hasani u ka thënë se ata kanë fatin të jenë dezurni i parë i Shqipërisë në NATO, prandaj të jenë korrektë e në lartësi të detyrës. Edhe kjo ka vlerën e vet.

Specialistët e vegjël të NATO-s

Po vinte 60-vjetori i NATO-s, ç’ duhej bërë? Rrethi i historianëve në bashkëpunim me Qeverinë e Nxënësve të shkollës vendosën dy veprimtari: një konkurs për historikun e Aleancës, dhe një stendë të re me foto e materiale nga historia e saj.

Që në fillim të marsit veprimtaritë qenë shpallur publikisht dhe menjëherë filloi organizimi i tyre. U shpall edhe rrethi i çështjeve, pyetjeve që do të përfshinte konkursi i historisë së NATO-s. Krahas tij filloi puna për stendën “NATO 60 vjet”. Grupi i punës u ndodh shpejt në vështirësi. U raportua se nuk po gjenin botime me foto për NATO-n. Filloi kërkimi nëpër revista dhe në internet. Më në fund grupi i punës arrin të grumbullojë mjaft foto, të bukura, me ngjyra e të gjitha dhe zgjedh ato më të mirat. Janë nxënësit ato që diskutojnë e vlerësojnë, që bëjnë stendën gati, duke ngjitur materialet. Në mbarim mësuesja e historisë, Vilma Kazazi shikon stendën dhe i përgëzon.

Në prag të samitit të NATO-s, më 2 prill, bëhet përrurimi i saj. Në

pushimin e madh, para stendës janë mbledhur mësues e nxënës. Flitet për 60-vjetorin e NATO-s, për Luftën e Kosovës dhe pranimin Shqipërisë në NATO, komentohen fotot e stendës dhe së fundi, urimet për pranimin e vendit tonë në NATO. Duartrokitje. Atë ditë e pas, hapësira para stendës është bërë pikë grumbullimi e nxënësve që zgjatin kokat për t’u njohur me materialet e saj.

Konkursi filloi së pari nëpër klasa, ku morën pjesë të gjithë nxënësit. Pastaj filloi faza e dytë mes skuadrave të klasave të të njëjtit vit. Festimi i 60-vjetorit dhe pranimi i Shqipërisë me të drejta të plota e gjeti konkursin në fazën e tij të

të jetë? Mund të thuhet me plot gojën se në tekstet tona ka nevojë të shtohet e rifreskohet informacioni për NATO-n.

Shumë emocionuese ishte përballja mes pesë skuadrave të klasave të shtata, nga të cilat e 7a dhe të 7b mendohej se mund të ishin fituese dhe në fakt u paraqitën shumë mirë. Ata kishin në radhët e tyre nxënës të shkëlqyer si Malbora Sina e Erisa Muçaku. Po konkursi, ka edhe ai rastësitë dhe “fatin” e vet. Skuadra e klasës së 7c ia arriti të merrte çdo pikë dhe të renditej e para. Kjo entuziazmoi shumë tërë klasën, po edhe mësuesen kujdestare, Zanën, që e gëzoi shumë kjo perfor-

Po vinte 60-vjetori i NATO-s, ç’duhej bërë? Rrethi i historianëve në bashkëpunim me Qeverinë e Nxënësve të shkollës vendosën dy veprimtari: një konkurs për historikun e Aleancës, dhe një stendë të re me foto e materiale nga historia e saj.

dytë. Kjo bëri që nxënësit të ndiqnin me vëmendje informacionet e medias dhe të grumbullonin shumë fakte e ngjarje. Ata janë njohur me rendin e ditës së Samitit të NATO-s, dhe me sugjerimet për një strategji të re të Aleancës. Jashtë konkursit plot pyetje kureshtarësh: kur do të ngrihet flamuri ynë në Shtabin e NATO-s më 3 apo më 4 prill; më 6 apo më 7 do të bëhej ceremonia e ngritjes se tij? Flamuri ynë, a do të valëvitej i pari? Po emri i Shqipërisë a do të renditet i pari në listën zyrtare të vendeve të NATO-s? Po data e pranimit zyrtar të Shqipërisë në NATO cila do

mancë e klasës së saj.

Konkursi ka bërë jehonë në të gjithë shkollën. Të gjithë duan ta ndjekin, por, meqë salla nuk i nxë, lexojnë komunikatat e herëpashershme të jurisë. Po edhe të tjerë duan të kontribuojnë. Mësuesja Marie Doçi e shoqëron konkursin me artistët e saj të vegjël, recitues, dhe grupin e vajzave që sfilojnë më veshje aq të bukura.

Dhe së fundi faza e tretë midis fituesve ku përballen skuadrat e klasave të 6a, 7c, 8d dhe 9a. Juria e përbërë nga mësues e nxënës e ka të vështirë të ndajë fituesit nga humbësit. Bëhen njëra pas

tjetrës pyetje shtesë për të nxjerrë fituesin mes skuadrës së klasës së 6a (Fabjona Çejku, Kujtesa Shehu, Arta Hyseni, Muhamet Cena dhe Miriam Murati) dhe 9a (Elsa Çerpja, Sara Balliu, Ervis Balliu, Roland Dunga, Marius Dervishi).

Këta janë me të vërtetë specialistë të vegjël të NATO-s. Mendoj se Këshilli shqiptar i Atlantikut të Veriut duhet t’i shohë më mirë e t’i forcojë lidhjet e tij me shkollat, ku mund të aktivizojë rrethe të “atlan-tistëve” të vegjël.


Ata që “flasin” me pikturë

Krahas rrethit të historianëve menjëherë janë renditur nxënësit e rrethit të vizatimit të shkollës, që shpallën se edhe ata do të zhvillonin një konkurs vizatimi me tematikë për NATO-n dhe pranimin e Shqipërisë si anëtare. “Këta anëtarët e rrethit të vizatimit të shkollës sonë janë shumë aktivë”, -thekson presidentja e Qeverisë së nxënësve të shkollës, Ermelinda Palushi. S’ke si të mos i japësh të drejtë. Anëtarët e këtij rrethi nuk kanë lënë rast e ngjarje pa kujtuar me vizatimet e tyre. Madje shumë të qëlluara. Ata kanë marrë pjesë në ekspozita deri në Muzeun Historik Kombëtar, ku disa janë vlerësuar edhe me çmime. Vjet ata mbushën një sallë me vizatimet e tyre për pavarësinë e Kosovës, për 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit etj.! Vizatime shumë të bukura dhe me shumë kuptim.

Ndërkohë nxënësit që marrin pjesë në rrethin e vizatimit ka ditë që kanë dorëzuar e dorëzojnë vizatimet e tyre te mësuesi i lëndës, Ali Shehu. Atyre u janë vënë në dispozicion dy stenda, por grupi i punës ka zgjedhur për publikim 32 vizatime, të cilat nuk i merr as stenda e madhe në katin e parë dhe as ajo e rrethit të pikturit të ri. Më në fund vendoset. Afishohen vizatimet më të mira. Një qilim i vërtetë, me vizatime për NATO-n dhe Shqipërinë si anëtare, ku motivi kryesor është Emblema e NATO-s dhe flamuri ynë kombëtar, Shqipëria dhe Kosova. Edhe rrethi i vizatimit shpall fituesit e tij. Me çmim të parë, Kujtesa Shehu, me çmim të dytë Dashamir Mata e Malbora Sina, me çmim të tretë, Edison Kolgjini, Kujtesa Cara dhe Blerina Bajraktari.

Shënim: Jo rastësisht Shkolla 9-vjeçare e Laknasit në Tiranë mori emrin e madh “Nënë Tereza”, që e mban me nder dhe krenari.

Sot pas 13 vjetësh këta nxënës kanë mbaruar Universitete e kanë mbrojtur grada shkencore, por edhe janë rreshtuar në Ushtrinë tonë e në repartet e saj që kanë kryer detyra e zhvilluar stërvitje në kuadrin e NATO-s.



Kosova është sot një kontribuuese aktive dhe një anëtare e respektuar e komunitetit ndërkombëtar. Si udhëheqëse e politikës së jashtme kam punuar ditë pas dite për të siguruar që të përfaqësohemi me dinjitet dhe me krenari në çdo cep të botës. Në këtë rrugëtim, fokusi ynë kryesor ka qenë përmbushja e synimeve tona shtetërore të përqendruara në forcimin dhe avancimin e marrëdhënieve të mira me shtete mike anembanë botës.



Presidente Osmani: 1 vit si presidentja juaj për Kosovën e së ardhmes, Kosovën e të gjithë qytetarëve të saj pa dallim

Ubë një vit, që kur kam marrë detyrën si Presidente e Republikës së Kosovës, si rezultat i besimit tuaj historik dhe vizionit të përbashkët për një të ardhme më të mirë. Viti i kaluar po aq sa ka qenë i veçantë, po kaq është karakterizuar nga shumë sfida lokale e globale. Pandemia dhe efektet e saj, kriza energjetike, e deri tek zhvillimet e fundit të sigurisë në kontinentin europian, na kanë dëshmuar se në sfida të përmasave të tilla, vetëm bashkëpunimi, besimi dhe komunikimi na mundësojnë të vazhdojmë përpara.

Kosova është sot një kontribuuese aktive dhe një anëtare e respektuar e komunitetit ndërkombëtar. Si udhëheqëse e politikës së jashtme kam punuar ditë pas dite për të siguruar që të përfaqësohemi me dinjitet dhe me krenari në çdo cep të botës. Në këtë rrugëtim, fokusi ynë kryesor ka qenë përmbushja e synimeve tona shtetërore të përqendruara në forcimin dhe avancimin e marrëdhënieve të mira me shtete mike anembanë botës. E me po kaq zell jam angazhuar që zëri ynë të dëgjohet edhe tek vendet të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë tonë.

- Si komandante supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kam punuar me përkushtim për të forcuar më tej interesin dhe sigurinë kombëtare të Republikës tonë. Duke punuar ngushtë me institucionet tona të sigurisë dhe partnerët tanë ndërkombëtar, jam përqendruar që Kosova të lëvizë përpara si partnere e besueshme që i shërben paqes globale. Po punojmë vazhdimisht drejt avancimit të rrugës sonë drejt integritimit euro-atlantik, që është aspiratë e qartë e popullit tonë për të ardhmen.

Ju kam premtuar një udhëheqje të përgjegjshme dhe të ndershme, dhe këto kanë qenë udhërrëfyesit në punën time çdo ditë.

Siç e dini, shteti i së drejtës është përkushtim i imi i vazhdueshëm me qëllim që ta rrënojim atë në të gjithë vendin. Në këtë frymë kam punuar secilën herë kur kam marrë një vendim, secilën herë që e kam bërë një emërim, dhe kjo ka jehuar në çdo deklaram e takim timin. Sepse, jam e bindur se barazia para ligjit, meritokracia, integriteti dhe profesionalizmi përfaqësojnë shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, të një vendi të zhvilluar, dhe të një demokracie të konsoliduar.

Përveç forcimit të pozitës sonë ndërkombëtare dhe forcimit të shtetit



të së drejtës, këtë vit jam angazhuar për ndërgjegjësim dhe bashkëpunim me ju në tri çështje të rëndësishme: fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri, ndërgjegjësimi dhe adresimi i sfidave me të cilat përballen fëmijët me nevojë të veçanta dhe rritjen e vetëdijes mbi kërcënimet

që i kanosen shëndetit tonë si rezultat i shkatërrimit të ambientit.

E them gjithnjë se sukseset e Kosovës nuk i përkasin një individ. Sukseset tona si shtet janë suksese të përbashkëta. E këtu, një kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë edhe

mërgata jonë. Si një vend i vogël, por ambicioz, besoj fuqishëm se ne mund të arrijmë akoma më shumë se sa kemi arritur deri më tani. Andaj, pres me padurim që së bashku me ju të punojmë drejt arritjes së sukseseve të reja.

Është detyrim i ynë i përbashkët

që të punojmë për vendin tonë dhe të sigurohemi që të kapitalizojmë potencialin e rinisë sonë, të sportistëve tanë, e artistëve tanë, të vajzave e të djemve tanë, të cilët po dëshmojnë çdo ditë e më shumë se ambiciet e një vendi nuk njohin kufij.

Gjersa reflektojmë rreth asaj se çfarë kemi lënë pas, shikimin e kemi gjithnjë përpara.

- Për katër vitet e ardhshme do të vazhdoj të punoj: për të udhëhequr politikën tonë të jashtme dhe për të dëshmuar në botë se Kosova është më shumë se sa dinamikat e përditshme politike, por është një vend paqedashës e me demokraci dinamike; për të garantuar sigurinë e çdo qytetari në Kosovë dhe funksionimin kushtetues të institucioneve; për të promovuar Kosovën si vend të gatshëm dhe të duhur për investimet e huaja, me diversitet në potencialin ekonomik; për të garantuar e promovuar një shoqëri të barabartë ku nuk tolerohet diskriminimi; për të promovuar meritokracinë dhe integritetin; për t'i treguar të rinjve se e ardhmja është këtu; Sepse kjo është Kosova e së ardhmes. Sepse kjo është Kosova e të gjithë qytetarëve të saj pa dallim.

Takimi

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, më 20 prill diskuton për Kosovën

Në seancën përkatëse pritet të marrin pjesë si Serbia ashtu dhe Kosova. Shqipëria është që prej janarit 2022 anëtare e Këshillit të Sigurimit (KS) dhe Kosova është për të një nga çështjet me interes të veçantë. Këshilli i Sigurimit e drejton këtë muaj Mbretëria e Bashkuar.

Takimi i fundit i KS është mbajtur në tetor 2021, gjashtë muaj më parë dhe që nga ai takim nuk ka pasur ndryshime të mëdha në raportet midis Kosovës dhe Serbisë. Një nga çështjet që ka preokupuar palët muajt e fundit ka qenë pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në zgjedhjet që u zhvilluan në Serbi. Serbia nuk e pranon pavarësinë e Kosovës dhe vazhdon ta shohë si provincën e vet autonome. Ky ka qenë edhe qëndrimi i fundit i presidentit serb Aleksandër Vuçiq në bisedimet Prishtinë-Beograd, të zhvilluara për herë të fundit korrikun e kaluar.

Lufta në Ukrainë ka rritur shqetësimin për acarimin e mundshëm të tensioneve në Ballkanin Perëndimor. Vendet e BE-së dhe SHBA-së kanë shprehur shqetësimin se Rusia mund të destabilizojë Kosovën. Si kushte për garantimin e paqes dhe sigurisë, Kosova ka kërkuar të bëhet anëtare e NATO-s dhe të ketë një bazë të përhershme amerikane dhe grup pune për integritetin e Kosovës në NATO, në vend.

Synimi kryesor i OKB-së në Kosovë është ruajtja e stabilitetit. Dhe mungesa e suksesit në bisedimet Prishtinë-Beograd të ndërmjetësuar nga BE, mund të bëjë që anëtarët e Këshillit të Sigurimit të kërkojnë nga të dy palët të rifillojnë bisedimet diplomatike dhe të japin një deklaratë ku të thonë se nuk do të përdorin dhunën kundër njeri-tjetrit.

Sa i përket 5 anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, qëndrimet janë të njohura. Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-të e njohin Kosovën dhe mbështesin qeverinë e saj, ndërkohë që Rusia dhe Kina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe mbështesin Serbinë dhe qëndrimin e saj. Nga 10 anëtarët e përkohshëm të KS, pesë e njohin pavarësinë e Kosovës (Shqipëria, Gaboni, Irlanda, Norvegjia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe), kurse pesë të tjera nuk e njohin (Brazil, Gana, India, Kenia, dhe Meksika).





PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

Buletin me vlera për
studiuesin ushtarak

AQFA në këtë fundviti botoi “Buletini Arkivor Ushtarak” me një përmbledhje të dokumenteve që gjenden për Traktatin e Vrashavës dhe Luftën e Ftohtë në Shqipëri. Botimi i këtij buletini, tashmë të mirëpritur nga studiuesi ushtarak dhe civil, ka sjellë dokumentet që janë pjesë e fondeve të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë herë bordi i botimit me shumë të drejtë ka publikuar dokumente që përfshijnë një periudhë shumë të veçantë të Luftës së Ftohtë, që lidhet me pjesëmarrjen e Shqipërisë në Traktatin e Varshavës prej vitit 1955-1968.

Lexuesi nëpërmjet dokumenteve që botohen për herë të parë, njihet me të dhëna të nxjerra nga Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH) dhe Drejtoria Politike që flasin për Traktatin e Varshavës dhe krijimin e Komandës së Bashkuar të FA-së dhe ndihmës reciproke të shteteve pjesëmarrëse si Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Polonia, Bashkimit Sovjetik (BS), Çekosllovakia dhe Republikës Demokratike Gjermane, si dhe të Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit Reciprok ndërmjet tyre.

Në këtë buletin do të njiheni me Komitetin Qendror të PPSH-së mbi mosmarrëveshjet që kishin lindur midis PK të Bashkimit Sovjetik dhe PK të Kinës, si dhe me mosmarrëveshjet midis Shqipërisë dhe BS për problemin e Bazës Luftarake-Detare të Pashalimanit. Dokumente të tjera paraqesin kursin e afrimit të shtetit shqiptar me Republikën e Kinës.

Buletini pasqyron në mënyrë të detajuar dokumente lidhur me ashpërsimin dhe qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj veprimtarisë antishqiptare të N. Hrushovit. Dokumente të tjera pasqyrojnë denoncimin e shtetit shqiptar të Traktatit të Miqësisë me këto vende etj.

Dokumentet pasqyrojnë dhe raportin e MMP, si dhe mbledhjen e Këshillit të Mbrojtjes së bashku me vendimet, si dhe masat për rritjen e mëtejshme të gatishmërisë luftarake të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë ndaj një agresioni të mundshëm ajror dhe detar nga forcat ushtarake të Traktatit të Varshavës.

Në Bazën Ushtarake të Pashalimanit

Në bazën ushtarake të Pashalimanit nga nëntori i vitit 1960, kishte filluar acarimi i marrëdhënieve të efektivit të përbashkët shqiptaro-sovjetik.

Ashpërsia e marrëdhënieve dhe ngritja e tensionit kishte filluar në gjysmën e dytë të nëntorit 1960, në ditët e fundit të marsit dhe në fillimet e majit të vitit 1961. Karakteristikë

e tyre ishte se qeveria sovjetike kishte organizuar dhe ndërmarrë sulme kundër qeverisë shqiptare dhe udhëheqjes së partisë.

Gjatë nëntorit, delegacioni i PPSH-së, që ishte në Konferencën e 81-të të Partive Komuniste dhe Punëtore në Kremlin nga udhëheqja sovjetike i bëhej shantazh.

Efektivit sovjetik të bazës ushtarake të Pashalimanit iu dha sinjali për të ndërmarrë veprime arbitrare në kundërshtim me marrëveshjet për bazën e përbashkët. Muajt dhjetor, janar, shkurt dhe në gjysmën e parë të marsit 1961, në bazën ushtarake të Vlorës u punua normalisht nga efektivit i përbashkët. Planet e stërvitjes luftarake, siç i vërtetojnë dokumentet, u zbatuan në rregull dhe regjimi operativ i bazës u zhvillua me kualitet megjithëse gabime dhe të meta të zakonshme shfaqeshin nga të dy palët.

Disa ditë para mbledhjes së komitetit politik konsultativ të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, në bazën ushtarake të Pashalimanit si me sinjal filluan të acaroheshin, kur këshilltarët dhe instruktorët sovjetikë shkelën rregullat e shërbimit të radës, ndërprejnë stërvitjen luftarake dhe daljen e anijeve në det. Kishte filluar një fushatë e hapur shpifjesh në masën e efektivit sovjetik kundër qëndrimit politik të qeverisë dhe partisë. Nga kronologjia e ngritjes së tensionit në bazën ushtarake të Pashalimanit nuk mund të mos tregohet qartë se miti i

ngritjes së tensionit dhe burimi i tij ishte Moska. Në gjysmën e dytë të marsit 1961 qeveria sovjetike me qëllim që të fabrikonte akuza për të vënë pjesëtarët e Traktatit të Varshavës përpara një situatë false të gjendjes në bazën ushtarake të Pashalimanit dhe të merrte aprovimin e tyre për prishjen e saj, iu dha udhëzime këshilltarëve dhe instruktorëve sovjetikë që të punonin në bazën për acarimin e marrëdhënieve me efektivin shqiptar.

Nga gjithë historiku i ngjarjeve del e qartë se në marrëdhëniet sovjeto-shqiptare, në bazën ushtarake të Pashalimanit, qeveria sovjetike në këtë bazë gjithnjë kishte parë jo një detashment të fuqishëm luftarak të kampit socialist në pellgun e Mesdheut, por një pikëmbështetje për shantazhe dhe presione të padrejta dhe pa baza ndaj qeverisë së Shqipërisë.

Duhej të largoheshin ata, sovjetikët

Me largimin e 8 nëndetësve në bazën e Katelnikov dhe me insistimin që bëri pala sovjetike për të mbajtur në Shqipëri instruktorë sovjetike në Flotën Luftarake Detare shqiptare, çështja që ishte për t'u zgjidhur nuk u zgjidh, për qëndrimin jo të drejtë të palës sovjetike u ngatërrua dhe më shumë.

Po çfarë u arrit me largimin e 8 nëndetësve në bazën Katelnikov nga pala sovjetike? Së pari, u dobësua mbrojtja e Republikës Popullore të

Shqipërisë dhe fuqia mbrojtëse e kampit socialist në basenin e Mesdheut; së dyti, u inkurajuan dhe më shumë armiqtë e Republikës Popullore të Shqipërisë në planet e tyre agresive kundër vendit tonë; së treti, u bë ajo që kërkonte Niksoni në bisedimet e tij me udhëheqësit sovjetikë, heqja dorë nga ana sovjetike nga baza lundruese detare e Vlorës si kusht paraprak për të filluar bisedimet rreth likuidimit të bazave amerikane dhe rreth problemit të çarmatimit. U bë pra, në këtë mënyrë edhe një lëshim paraprak i imperializmit për hir të bisedimeve me të. Kuptohet që këto “suksese” sovjetike jo vetëm që nuk e forconin pozitën e sistemit socialist në botë, por e dobësonin atë. Sovjetikët arritën deri aty sa çështjen e largimit të instruktorëve sovjetikë nga grupi i nëndetësve e quajtën “problem të ri” dhe jo hallkën më të vjetër, më të njohur dhe burimin e të gjithë fërkimeve të ndodhura në bazë.

Për bazën luftarake detare të Pashalimanit dhe mos marrëveshjet e ndodhura, ka shumë dokumente dhe materiale. Në të gjitha këto materiale del qarte se instruktorët sovjetikë, u sollën si komandantë, shkelën dispozitat e karakterit të punës, fyen dinjitetin personal të njerëzve dhe krijuan shkaqe për fërkime. Të evitoheshin fërkimet dhe skandalet duhej tamam të largoheshin ata, sovjetikët. Kjo gjë ishte dhe burimi i mosmarrëveshjeve që lindin në bazë.

Këto qëllime jomiqësore të palës sovjetike nuk mund të realizoheshin. Në një dokument theksohet se: “Pala shqiptare, duke ruajtur respektin e thellë për njerëzit sovjetikë nuk do t'i lejojë instruktorët e bazës luftarake detare të Pashalimanit që të sillen siç janë sjellë deri me sot brutalisht me dinjitetin tonë nacional. Në bazë të marrëveshjeve që ju keni hedhur poshtë nuk do t'i lejojmë ata as të sillen si zot të anijeve, as si komandantë, as të sigurojnë shërbime të veçanta roje, as të merren me punë agjitative kundër udhëheqjes së Partisë e të shtetit tonë siç janë marrë deri tani një pjesë e tyre dhe as të lidhen direkt, d.m.th. jo nëpërmjet komandës sonë të Flotës me ndërlidhje me mjete radioteknike me jashtë, gjë që është në kundërshtim me të drejtat tona si shtet sovran. Pala jonë edhe në këto kondita që ju me qëllim ecni në rrugën e acarimit të marrëdhënieve midis vendeve tona, nuk ka kundërshtim që të mbahet ndërlidhja teknike midis flotave tona, por jo këtë ta bëjnë persona individë të ndodhur në Shqipëri me cilësinë e instruktorit”.

Duke insistuar në tërheqjen e menjëhershme të instruktorëve sovjetikë nga Flota luftarake detare shqiptare, qeveria shqiptare paralajmëroi se mbi këto vija pala jonë do të përpqet për të vënë në binarët e nevojshëm, sipas marrëveshjeve ekzistuese aktivitetin dhe qëndrimin e mëtejshëm të padëshiruar nga ne të instruktorëve

Shqipëria, Lufta e Ftohtë, Traktati i Varshavës dhe baza ushtarake e Pashalimanit



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ
MJESHTËR I MADH

Përgatitja e pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste

Që në tetor 1928 Musolini i drejtoi shigjetat nga Shqipëria

Më 7 prill 2022, mbushen 83 vjet nga dita kur Italia fashiste sulmoi dhe pushtoi Shqipërinë. Agresioni fashist kundër vendit tonë u mendua dhe u përgatit me kohë nga qarqet imperialiste italiane. Ai ishte pasojë e synimeve dhe veprimeve të fuqisë imperialiste, për ndarjen dhe rindarjen e botës. Veçanërisht në gjysmën e dytë të viteve '30 të shek. XX, si rezultat i pazarllëqeve të tyre për të marrë nëpër këmbë sovranitetin dhe pavarësinë e vendeve të vegjël, siç ishte edhe vendi ynë. Nga ana tjetër ky agresion ishte përfundimi i politikës antipopullore dhe antikombëtare të regjimit të Zogut, e nxori Atdheun në ankand, përgatiti 7 prillin e 1939 dhe e shiti Shqipërinë te Italia fashiste. Shqipëria, me pasuritë e saj mbi dhe nëntokësore, me pozitën e rëndësishme që zë në Adriatik dhe në gadishullin e Ballkanit, ka qenë objekt i lakmisë së fuqive të kohës dhe në radhë të parë i shteteve fqinjë, të cilët synonin të gllabëronin apo ta copëtonin në marrëveshje ose në rivalitet me njëri-tjetrin. Veçanërisht fashizmi italian është përpjekur ta pushtojë dhe ta përdorë territorin e vendit tonë si rrugëkalim për ekspansion në Ballkan, për të siguruar epërsinë e padiskutueshme ushtarako-detare në Adriatik, siç pat thënë, në fillim të këtij shek. XX, Titoni, ish-ministër i Jashtëm i Italisë. Me ardhjen e fashizmit në fuqi në tetor 1928, Musolini, ashtu si paraardhësit e tij, duke ëndërruar për krijimin e perandorisë romake me anën e forcës, i drejtoi shigjetat në radhë të parë nga Shqipëria. Duke pushtuar Shqipërinë, fashistët italianë mendonin ta vinin në vend edhe disfatën e turpshme politike dhe ushtarake që pësoi Italia në Vlorë më 1920. Benito Musolini, duke shprehur keqardhjen më të madhe, shkruante në artikullin me titull "Amissimo", botuar në gazetën "Papen d' Italia" në korrik 1920, se Kaporetjoja shqiptare është shumë më e rëndë se tjetra që u zhvillua midis Isonco dhe Piaves... Ai pohonte se në Vlorë, Italia u mund dhe u mund si s'ka më keq.

Situata politike dhe ushtarake në prag të pushtimit të Shqipërisë
Musolini së bashku me Cianon,



më 29 mars 1939 përcaktuan planin përfundimtar për pushtimin e Shqipërisë me anën e forcës. Këtë ia paraqitën dhe Zogut, më 2 prill në formë ultimatum, i cili përfundonte në orën 12.00 të datës 6 prill 1939. Në rast se kërkesat nuk pranoheshin nga Zogu, do nxiteshin kryengritje me përkrahës të Italisë fashiste, duke shpallur deklarata dhe thirrje Italisë për ndihmë dhe njëkohësisht të zbarkonin forcat, të cilat vazhdonin përgatitjen për të qenë gati më 1 prill. Në shtimin e tensioneve në marrëdhëniet italo-shqiptare, qeveria italiane tërhoqi më 5 e 6 prill me anije luftarake dhe motonavë, rreth 2 000 qytetarë italianë, gjoja jeta e tyre dhe koncesionet e pozitave të tjera të rëndësishme ekonomiko-italiane ndodheshin përpara një rreziku të madh. Ndërsa demonstratat patriotike dhe anti-italiane të zhvilluara në Shqipëri për të ndaluar agresionin fashist dhe të mbronin vendin, fashistët italianë, i paraqisnin si

manifestime "rebelësh". Demonstruesit nuk u shkaktuan asnjë dëm as qytetarëve italianë dhe as pronave të tyre në Shqipëri. Për këtë fakt dëshmonte dhe ministri anglez në Shqipëri A. Rajan, i cili shkruante, në raportin e tij drejtuar funksionarëve të lartë të Forcimit, Ingram, më 11 prill 1939, se asnjë italian nuk i është vënë në rrezik jeta në këtë vend deri më 5 dhe 6 prill, ku ata pothuajse të gjithë e zbrazen vendin në përgatitje për invadim.

Në Tiranë qëndruan funksionarë dhe oficerë të shërbimit diplomatik, si dhe disa persona të tjerë, për të mbrojtur Legatën Italiane nga "bandat e jashtëligjshme". Zogu në përgjithësi nuk ishte kundër nënshkrimit të një traktati ushtarak, për të përligjur zbatimin e trupave italiane në Shqipëri. Zogu, më 3 prill, me anë të ATSH-së deklaronte se lajmet e përhapura nga gazetë e huaja lidhur me përgatitjen e një agresioni fashist italian kundër Shq-

përisë janë "tendencioze" dhe "kanë për qëllim t'i paraqesin në mënyrë të gabuar marrëdhëniet miqësore që ekzistonin midis Shqipërisë dhe Italisë". Këto fjalë thuheshin pikërisht në një kohë kur trupat italiane prisnin në Bari, Brindisi e Taranto vetëm urdhrin për sulmin kundër Shqipërisë. Ndërkohë qeveria e Zogut, e vënë përpara këtij ultimatum, afati i të cilit mbaronte në mesditën e 6 prillit dhe alternativës se pranimit të një protektorati italian ose të një pushtimi ushtarak, u detyrua t'i paraqiste, në pasditen e 5 prillit, qeverisë italiane kundërpropozimet e saj, që nuk ishin gjë tjetër veçse një akt i turpshëm kapitullimi dhe tradhtie ndaj Atdheut.

Parlamenti shqiptar, u mbledh në pasditen e 6 prillit, aprovoi propozimet e Zogut dhe vendosi që pushtimi ushtarak i Shqipërisë të ligjërohej me anë të një konvente ushtarake që do të ruante formalisht sovranitetin e

Shqipërisë. Në parlament kishte dhe një rrymë të fortë që ishte për pushtimin ushtarak pa kushte të Shqipërisë. Këto propozime u bënë në një kohë kur mbi qiellin shqiptar në pasditen e 6 prillit, fluturuan bombarduesit e parë italianë dhe kur makina luftarake fashiste ishte në lëvizje, e Zogu nuk ishte në gjendje ta ndalonte atë. Zogu duke dashur të merrej vesh me çdo kusht me italianët, prapa shpinës së popullit shqiptar, në mbrëmjen e 6 prillit i propozoi qeverisë italiane për të nënshkruar marrëveshjen ushtarake me gjeneral Parianin, propozim ky që u përsërit edhe në orën 4.00 të datës 7 prill, kur anijet luftarake italiane po i afroreshin porteve shqiptare. Përgjigja e Romës ishte e prerë: t'i drejtohej gjeneral Guxonit që donte të thoshte se e vetmja gjuhë për t'u marrë vesh ishte gjuha e armëve.

Zogu dhe ushtria e tij tradhtuan vendin

Ushtria e Zogut, megjithëse u vu në gatishmëri, në çastin më vendimtar për fatet e Atdheut nuk mori asnjë urdhrë për të luftuar, por u shpërbë dhe u shpërnda menjëherë dhe krejtësisht përballë agresionit fashist. Një rol të madh në shpërbërjen e ushtrisë shqiptare luajtën dhe oficerët profashistë të ushtrisë së Zogut. Këta të zhveshur nga çdo ndjenjë patriotike, sabotuan dhe shtypën çdo dëshirë e përpjekje të ushtarëve dhe të disa oficerëve patriotë për të luftuar, siç bënë në Shkodër, Durrës etj., shpërndanë në panik repartet e tyre, siç bënë me forcat e garnizonit të Tiranës në Kërrabë, tentuan të prisnin me flamur të bardhë pushtuesin, siç deshë të bënte komandanti i xhandarmërisë së qarkut të Gjirokastrës etj. Shumë prej tyre, veçanërisht oficerë madhorë, me në krye komandantin e mbrojtjes kombëtare gjeneral Aranitasin, në çastet më vendimtare për fatet e Atdheut, braktisën repartet dhe postet e tyre luftarakë dhe ua mbathën

sovjetikë, që ju insistoni të mbani në bazën luftarake detare të Pashalimanit.

Qëndresa e oficerëve dhe marinarëve shqiptarë

Në janar të vitit 1961, kundëradmiral Hito Çako ngriti në këmbë me alarm luftarak brigadën e ruajtjes së rajonit të ujërave në ishullin e Sazanit dhe garnizonin e ishullit, ndërsa kundëradmirali Abdi Mati i shpalli alarm shtabit dhe organeve të drejtimit të flotës në Pashaliman. Mbi ngritjet në alarm luftarak nuk u informuan këshilltarët dhe komandanti i Brigadës së Nëndetësive.

Po në muajin janar 1961, RLS e tipit "Lot" në ishullin e Sazanit diktoi në kanal e Otrantos një grup

anijesh të panjohura (deri 20 copë). Por këshilltarët në shtabin e flotiljes dhe komanda e brigadës së nëndetësive nuk u njoftuan. Në shkurt 1961 përsëri u diktua një grup anijesh të panjohura në kanal e Otrantos. Por edhe në këtë rast këshilltarët dhe brigada e nëndetësive nuk u vunë në dijeni. Gjithashtu nuk u mor asnjë masë për rritjen e gatishmërisë luftarake të flotës dhe për zbulim. Oficerët e rojës të grupit shqiptar të nëndetësive nxjerrin në radë me kokën e tyre, pa lejen e oficerit të rojës të brigadës, anije ndihmuese dhe katera. Vazhdimisht bëhej lundrim i katerëve dhe anijeve të flotës në rajonin e Pashalimanit nëpër poligonet e stërvitjes pa pëlqimin e komandantit të brigadës

së nëndetësive.

Kështu, ish komandanti i flotiljes shqiptare, kundëradmiral Abdi Mati, në fund të vitit 1960 i dha urdhrë komandantit të brigadës së nëndetësive në një formë të ashpër e brutale duke kërkuar që të vihej në punë baza lundruese "Nemçinov" menjëherë dhe pa marrë parasysh motin (në kohë kur frynte erë e fortë, kishte dallgë dhe ishte errësirë).

Në bazën lundruese "Nemçinov", ku ekuipazhi shqiptar ndodhej me cilësinë e nxënësit, dhe anija ishte nën përgjegjësinë dhe drejtimin e ekuipazhit dhe komandantit sovjetik, shërbimi shqiptar i dezurnit shkeli rregullat e shërbimit të anijes. Në anije hynin e dilnin dhe shumë oficerë

dhe marinarë shqiptarë, gjë për të cilën komandanti sovjetik nuk vihej në dijeni.

Komandanti i ekuipazhit shqiptar të bazës lundruese "Nemçinov", Kapiteni i Rangut të 2-të Stavri Çika dhe ndihmësi i tij Kapiteni i Rangut të 3-të Jani Bushi, me kokë të tyre japin udhëzime për vendosjen e oficerëve në kabina pa rënë dakord me komandantin sovjetik, ndërsa disa oficerë shqiptarë okupuan arbitrarisht kabinat. Kështu kanë vepruar dhe Kapiteni i Rangut të 3-të Dashamir Ohri, komandanti i nëndetës S-270 Toger Aleko Pojani, Kapiteni i Rangut të II-të Shezai Kasaj, Kapiteni i I-rë Muharrem Molla, komandant Toger Petrit Pojani, etj.

Duke qenë se arkivi mbart kujtimet e një periudhe të caktuar historike të vendit, krijon dhe një mundësi për të komunikuar pozitivisht me studiuesit dhe me publikun, duke nxjerrë në pah cilësitë morale dhe njerëzore, disiplinën dhe përgatitjen, ndjenjën e fortë që ka karakterizuar pasionin për të bërë një forcë të armatosur për të ecur përpara.

Sfidat që qëndrojnë sot për arkivin kërkojnë nxitjen e këtij procesi, përdorimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, duke e kthyer në një qendër dhe burim të njohurive dhe të krijimtarisë të FA-së. Ky rrugëtim i Buletinit Arkivo-Ushtarak tashmë është i përcaktuar qartë dhe FA-të krenohen me një institucion të tillë.

73 vjet
30 vende
2 kontinente
1 miliard njerëz
dhe 1 Aleancë



Siguria globale po zhvillohet por aleatët e NATO-s
do të mbeten gjithnjë të bashkuar në mbrojtje të
demokracisë, sigurisë dhe lirisë sonë. Ne jemi NATO

